# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Aktrim"**

**ofruar nga**

**Universiteti i Arteve**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Elida TABAKU**

**Prof. as. Dr. Florenca STAFA**

**Shtator/ 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**
**Bachelor në "AKTRIM"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Arteve |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Aktrimit dhe Teori |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Aktrim" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 517, datë 08.08.2007 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër Nr. 76, datë 12.02.2011 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike / 6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 kredite ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Studime me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve | Niveli 6 (gjashtë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit | 2024-2025: 15 PAE/ 10 PAK<br>2023-2024: 16 PAE/ 11 PAK<br>2022-2023: 18 PAE/ 8 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2022-2023: 10<br>2023-2024: 11<br>2024-2025: 9 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në Aktrim ofrohet nga Departamenti Aktrim dhe Teori arti, pjesë e Fakultetit të Artit Skenik, në Universitetin e Arteve (UART). Fakulteti i Artit Skenik ka tre departamente: Departamentin "Aktrimit - Teori Arti, Departamentin "Regji- Regji Filmi dhe Televizioni dhe Departamentin "Skenografi-Kostumografi-Koreografi dhe lëshon diplomë në: aktrim, regji teatri, skenografi & kostumografi, koreografi, regji filmi & tv.

Universiteti i Arteve ka patur disa emërtesa gjatë viteve. Në themelimin e vet më 1966 ai quhej Instituti i Lartë i Arteve (ILA), pas viteve '90-të Akademia e Arteve dhe në vitin 2011 mori emërtimin përfundimtar Universiteti i Arteve (UART). Programet e studimit janë vazhdime të një tradite të ngritur prej vitesh dhe që pasurohet dhe rifreskohet me elemente bashkëkohorë duke u mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë,V.K.M. dhe Udhëzimet përkatëse.

UART është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë me profil artistik në Republikën e Shqipërisë. Misioni i UART përfshin: ofrimin e arsimimit të lartë artistik dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës; zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; thellimin e kualifikimit artistik, profesional dhe shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore.

Programi i studimit Bachelor në Aktrim fillon rrugëtimin e tij që në vitin 1956 kur u hap Shkolla e parë për aktorë në Shqipëri pranë Teatrit Kombëtar, por në Programin e Studimit Aktrim (Dramë) janë hedhur në vitin 1982, në ILA.

Programi përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata që ka si synim krijimin e njohurive bazë, koncepteve, aftësive teorike dhe praktike mbi Aktrimin. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike. Programi ofron kualifikim të nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit në të për të vijuar studimet në programe të ciklit të dytë.

Programi i Studimit Bachelor në Aktrim i cili ofrohet nga A&T/FAS për shkak edhe të veçorisë së tij, numrit të kontrolluar të studentëve, si dhe mënyrës së pranimit në të (me konkurs dhe jo sipas listave të mesatareve) drejtohet nga motoja: "Studenti në qendër". Programi i studimit "Aktrim " u bën të njohur studentëve kërkesat dhe metodikën e punës për formimin e gjithanshëm profesional të studentëve si krijues dhe interpretues, me synim përgatitjen e aktorëve të pavarur, artistë dhe intelektualë që janë në gjendje të krijojnë art. Gjatë vizitës në institucion dhe në takimet më pedagogë dhe studentë, GVJ vuri re një përkushtim të stafit akademik për realizimin cilësor të programit, duke bashkëpunuar me studentët, duke i njohur mirë ata dhe duke synuar në aftësimin e tyre artistik. Departamenti punon jo vetëm për formimin aktorial të studentëve në institucion, por edhe me përfshirjen e tyre në njohjen e punës së aktorit në Teatrin Kombëtar, Teatrin Eksperimental, Metropol, në Teatrin e Kukullave dhe të Marionetës, në emisione dhe filma televizive si dhe atë te filmit dokumentar dhe atij të kinemasë.

Stafi akademik përbëhet nga aktorë të njohës të skenës të cilët, sipas takimeve me studentët të organizuar ngë GVJ, dinë të punojnë shumë mirë si pedagog dhe bashkëautorë më studentët.Energjia positive reflektohet në pjesëmarrjen e studentëve në shumë veprimtari artistike.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në Fakultetin e Artit Skenikë u zhvillua gjatë dy ditëve, më 29 dhe 30 Prill 2025. Aktivitetet nisën me një takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, ku u diskutua mbi ecurinë dhe organizimin e vizitës, së bashku me Koordinatorin Teknik të ASCAL-it Msc Rajna Lila dhe Koordinatorin Institucional.

Më pas u zhvillua një takim me Dekanin e Fakultetit të Artit Skenik dhe Përgjegjësin e Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë, ku u trajtuan çështje që lidhen me strukturën, funksionimin dhe zhvillimet në departament. Vijoi takimi me përfaqësuesit e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për të dy programet e studimit që ishin objekt i vlerësimit. Më tej, u mbajt një takim me stafin akademik të angazhuar në këto programe, si me ata me status efektiv, ashtu edhe me të angazhuarit me kontratë.

Pas një pushimi të shkurtër për drekë pune, grupi u takua me studentët e të dy programeve të studimit, për të dëgjuar opinionet dhe përvojat e tyre lidhur me procesin mësimor dhe përmbajtjen e programeve. Më vonë, u realizua një takim me përfaqësues të sektorëve përgjegjës për çështjet mësimore dhe kurrikulare, informimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe me përfaqësues të rrjetit të ish-studentëve (Alumni). Dita e parë u përmbyll me një vizitë në sekretarinë mësimore dhe një takim përmbyllës të shkurtër mes palëve pjesëmarrëse.

Në ditën e dytë, aktivitetet nisën me një tjetër takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, për të përgatitur vijimin e punës. Më pas u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku u diskutua mbi mekanizmat dhe dokumentacionin e brendshëm të cilësisë në institucion. Vizita vijoi me një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, si dhe me Zyrën e Projekteve Artistike dhe Shkencore, ku u diskutua mbi përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte të ndryshme.

Në pjesën e dytë të ditës u realizua një vëzhgim i mjediseve të fakultetit, duke përfshirë auditorët, laboratorët, bibliotekën dhe shërbimet mbështetëse për studentët. Vizita u përmbyll me një takim me Përgjegjësin e Departamentit, ku u ndanë përshtypjet, u prezantuan gjetjet dhe u përmbyll procesi i vlerësimit për këtë fazë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof As. Florenca Halili (Stafa), Prof. Elida Tabaku dhe koordinatore teknike në ASCAL, Msc. Rajna Lila.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Aktrim".

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Bachelor "Aktrim" ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe të Planit Strategjik të Universitetit të Arteve "si dhe me misionin A&T, si njësi përbërëse të tij. Programi I studimit "Aktrim" është hartuar duke respektuar Ligjin për Arsimin e Lartë, dhe të gjithë bazën ligjore në fuqi, në përvojën e gjatë në fushën e aktrimit duke ruajtur interest kombëtare. PS ofrohet në gjuhën shqipe dhe ofron mundësi unike edukimi në fushën e Aktrimit, dhe synon të ruajë, konsolidojë dhe promovojë vlerat akademike, artistike si dhe kulturore kombëtare. GVJ nëpërmjet analizës së dokumentave vë re se programet e studimit të ciklit të pare në A&T ofrojnë programe konkurruese, me tipare thellësisht kombëtare dhe njëherazi të mbështetura edhe në traditën tone më të mirë. UART nëpërmjet mekanizmave të pranimit dhe formimit të studentëve synon të sjellë prurjet më të mira, më konkurruese e më origjinale për institucionet artistike e kulturore të vendit si dhe për jetën shoqërore e artistike dhe produktin shpirtëror shqiptar në të gjitha trevat shqipfolëse.<br><br>*(Evidenca 1.10 "Themelim ii Institutit të Lartë tëArteve")*<br>*(Evidenca l. II (Kurs I I pare I regjizorëve pranë Shkollës së lartë përAktorë "A. Mojsiu" (Drama)*<br>*(Evidenca I. 12 "Krijimi i Akademisë së Arteve ")*<br>*(Evidenca 1.13 "Krijimi i UART")*<br>*(Evidenca 1.14 "Rregjistrimi i formës së diplomave UART 2011")*<br>*(Evidenca 1.5 "Statuti i UART")*<br>*(Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit")*<br>*(Evidenca 1.16 "Rregullorja e NjësisëKryesore FAS")*<br>*( Evidenca I. 17 "Rregullorja e Departamentit A&T")*<br>*(Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim ")* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se UART dhe Fakulteti i Artit Skenik si një nga njësitë kryesore të tij, ofron programe studimi në fushën e edukimit, duke synuar arritjen e standardeve të larta akademike. Programi i studimit "Aktrim" plotëson kriteret në hartimin e tij dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe fushën e veprimtarisë së tij. Misioni i Programit të Studimit Bachelor në Aktrim përputhet plotësisht me qëllimet dhe misionin e UART i cili është: Ofrimi i arsimimit të lartë artistik dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës; zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit; formimi i studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; krijimi i bazave për kualifikimin artistik, profesional dhe shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; kryerja e studimeve artistike-kërkimore-shkencore. Për të zhvilluar më tej artin e kulturën; ndihmesa në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e te rinjve.<br><br>*Evidenca 1.5. "Statuti i UART"* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në "Aktrim" ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të UART, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, që ka mision integrimin rajonal, evropian dhe global, duke çuar më tej atë traditë që e bën UART një nga IAL-të shqiptare konkurrente me produktin e saj në tregun evropian dhe botëror. Plani i zhvillimit strategjik të UART ndërthur vizionin e arsimit të lartë në përgjigje të sfidave me hapat praktikë të nevojshëm për plotësimin e detyrave që vijnë nga procesi i Bolonjës.FAS/UART synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, artistik, e kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve në fushën e Aktrimit. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin dhe projektet artistike, FAS kërkon të përgatisë jo vetëm aktorë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.<br><br>*(Evidenca Nr 1.19 "Mbi miratimin e Planit të zhvillimit strategjik të UARTpër vitet akademike 2018-2025 ")*<br>*( Evidenca 1.4 "Për dhënien e Statusit të veçantë UART")*<br>*(Evidenca 1.5 "Statuti i UART")*<br>*(Evidenca Nr 1.20 "Rregullorja e UART")*<br>*( Evidenca I. 16 "Rregullorja FAS")*<br>*(Evidenca I. 15 "Rregullorja e Ciklit te Pare të Studimeve Bachelor në UART")*<br>*(Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit te Studimit Bachelor në Aktrim ")* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një program studimi në atë fushë. | Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UART ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Aktrim". Departamenti Aktrim & Teori ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar këtë program. Ky departament në përbërje të tij ka si personeli akademik efektiv 13 pedagogë prej të cilëve 3 (tre) janë Profesorë; 2(dy) Prof.Assoc.Dr, 2 (dy) Profesorë te Asociuar; 3 (tre) Doktorë;<br><br>2 (dy) Asistent Lektorë, të dy në proces Dr dhe 1(një)Docent. Ndërsa personeli akademik me kontratë është një me titull akademik Profesor.Bazuar në CV-të e stafit akademik, GVJ konstaton se stafi është më shumë përvojë akademike dhe aktoriale, i përshtatshëm për disiplinat specifike të këtij programi studimi. Nga vetë specifikat e programit dhe të Statusit të Veçantë që ka Institucioni rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik. Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.<br><br>*(Evidencë 1.4 "VKMNr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë UART")*<br><br>*Evidencë 3.4_Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencore të stafit AKTRIM.pdf*<br><br>*Evidencë 3.11_Pasqyrat e ngarkesave.pdf* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | GVJ konstaton se fusha e përgjithshme e programit të studimit, që përket fushës së arteve të performuara, (0215), është në përputhje me fushën akademike e studimore të njësisë kryesore, FAS (021), përgjegjëse për programin e studimit.Programi i studimit "Aktrim" në emërtimin e tij, formën e organizimit si dhe në strukturën dhe përmbajtjen e vet, i përmbahet fushave dhe drejtimeve akademike që përcakton UART dhe që shprehet në Strategjinë e zhvillimit strategjik të UART-së dhe në rregulloren e tij. Programi është në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e zhvillimit të UART dhe me veprimtarinë akademike mësimore e kërkimore të njësisë bazë, duke siguruar ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të mbështetur programin e studimit në të gjitha nivelet, teorike, praktike dhe laboratorike. Është bërë kodifikimi sipas udhëzimeve kombëtare dhe evropiane , kështu ky PS ka kodin Bachelor ne Aktrim 63BA0215S. Programi është projektuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, duke siguruar që objektivat mësimore dhe rezultatet e të nxënit të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *(Evidenca 1.22. I "Procesi i kodifikimit të programeve*<br>*(Evidenca l. 22.2 "Shkresa Nr. 7381/4 Prot. MAS "Njoftim mbi procesin e kodifikimit te programeve ")*<br>*(Evidenca 1.22.3 "Kthim përgjigie Njoftimit mbi procesin e kodifikimit të programeve te studimit")*<br>*(Evidenca 1.23 "Specifikimet dhe Përmbajtja e Programeve Të Studimit")*<br>*(Evidenca 1.24 European Standards and Guidelines-ESG 2015)* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Programi i studimit Bachelor në "Aktrim" ofrohet në Universitetin e Arteve në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.*<br>*Programi i studimit ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që kanë të njëjtën fushë akademike me atë të këtij program studimi.*<br>*Ky program studimi synon të përgatisë specialistë në fushën e Aktrimit. FAS/UART synon të mbetet qendra më e madhe dhe më cilësore e edukimit universitar, pasuniversitar, artistik, e kërkimit dhe trainimit për përgatitjen profesionale të aktorëve. Duke ndërthurur edukimin me kërkimin dhe projektet artistike, FAS kërkon të përgatisë jo vetëm aktorë të kualifikuar, por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.*<br>*Hartimi dhe zbatimi i programit të studimit është në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.*<br>*Njësia bazë që ofron këtë PS ka kapacitetet e duhura njerëzore për ta mirëmenaxhuar këtë program. Stafi akademik rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm për disiplinat specifike të këtij program studimi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron | Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, Statutin dhe Rregulloren e UART si dhe aktet rregullatore specifike. GVJ analizoi gjithashtu edhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në |

| | |
|---|---|
| marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi Brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | institucion dhe konstaton se UART siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UART ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës.<br>Personeli akademik në Departamentin Aktrim-Teori Arti/FAS që zhvillon Programin Bachelor në Aktrim gëzon status dhe trajtim të veçantë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në zbatim të VKM Nr. 145, datë 10.03.2021. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim sigurohen marrëdhënie bashkëpunimi brenda FAS/UART. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Arteve dhe Edukimit dhe në tërësi në UART. FAS/A&T rekruton me përparësi personel akademik të kualifikuar. Institucioni ndjek një politikë integruese te personelit akademik, personelit ndihmës mësimor artistik-shkencor dhe personelit administrativ.<br>Analiza e vazhdueshme e punës së strukturave realizohet nëpërmjet treguesve të matshëm të realizimit të detyrave dhe i shërbejnë përmirësimit të punës në lidhje me zbatimin e programit të studimit.<br><br>*Evidenca 1.4 'Për dhënien e Statusit të vecantë UART"*<br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART"*<br>*Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të perfomancës vjetore "*<br>*Evidenca 1.26 "Organigrama e UART e miratuar nga MASR së bashku me Statutin e UART"*<br>*Evidenca 1.27 "Tabelat e stafit akademik FAS"*<br>*Evidenca 1.15Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor ne UART.pdf*<br>*Evidenca1.17 Rregullore e vepramtarisë së përgjithshme e Departamentit Aktrim dhe Teori.pdf*<br>*Evidenca1.18 Rregullorja e programit të studimit Aktrim.pdf* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | GVJ, bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UART ka zhvilluar dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik-shkencor me shumë universitete dhe institucione në Evropë si dhe institucione të arsimit të lartë në vend. Bashkëpunimi realizohet ose formalizohet në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe apo edhe jashtë tyre. Këto shërbejnë si instrumente të politikës institucionale për të mbështetur veprimtaritë në fushën e mësimit tëkrijimtarisë artistike dhe kërkimit.<br><br>FAS/UART i jep një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në bashkëpunime ndërkombëtare të cilat mundësojnë mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik me kohë të plotë. Në kuadër të kësaj politike gjithëpërfshirëse dhe ndërkombëtarizuese të institucionit, |

| | |
|---|---|
| | UART vitet e fundit ka disa marrëveshje partneriteti në kuadër të projektit Erasmus+.<br><br>*Evidenca 1.28 "UART ne marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër te projektit Erasmus dhe Erasmus + "*<br>*Evidenca 1.29 "Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit"* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Referuar DVV,si dhe takimeve në Institucion konstatohet se FAS/UART bashkëpunon me institucione të tjera në vend për t'u ofruar mundësi studentëve për realizimin e praktikave profesionale dhe projekteve të ndryshme. Realizimi i këtyre bashkëpunimeve arrihet nën mbështetjen e pedagogëve udhëheqes të tyre, si dhe në kontakt me profesionistë të fushës përkatëse dhe për të siguruar një ndjekje nga afër të proceseve krijuese në institucionet bashkëpunuese. Një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi janë realizuar nga UART edhe në kuadër të "Paktit per Universitetin".<br>Në kuadër të bashkëpunimit me këto instanca shtetërore është arritur plotësimi i nevojave të studentëve për realizimin e programeve të tyre, për secilën fushë studimi.<br>Programi i studimit Bachelor në Aktrim i ofruar nga FAS/UART parashikon në planin mësimor lëndën "Praktikë profesionale" të shtrirë në të tre vitet e studimit e cila zhvillohet si në UART ashtu dhe në institucione të tjera, siç parashikohet edhe në rregulloren e programit. Këto marrëveshje bashkëpunimi i shërbejnë strategjisë së institucionit për zhvillimin e mëtejshëm dhe cilësor të programeve të studimit.<br><br>*Evidenca 1.29 "Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit"*<br>*Evidenca1.18 Rregullorja e programit të studimit Aktrim.pdf* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | GVJ konstaton se Departamenti A&T që ofron këtë PS në bashkëpunim me Dekanatin e FAS, në mënyrë periodike, merr në shqyrtim gjendjen aktuale dhe analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të Programit të Studimit. Analiza synon që njësia të perfitojë maksimalisht nga kontributet e tyre në vijim të bashkëpunimeve. Në takimin e GVJ me pedagogë dhe studentë u theksua se falë marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve me institucionet kryesore të artit dhe kulturës në vend është siguruar që studentët e këtij programi të marrin pjesë në aktivitete të shumta që organizohen, por që të realizojnë edhe një pjesë të mirë të provimeve të tyre (shfaqje të hapura për publikun) në mjediset e ofruara nga këto institucione. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 1.30 "Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere në 3 vitet e fundit"* |
| **Konkluzione** | *UART në rregulloret e miratuara për secilën njësi kryesore, bazë dhe program studimi ka të përcaktuara qartë rolin dhe detyrat e secilit aktor duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Artit Skenik dhe në tërësi në UART.*<br><br>*UART ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe ka zhvilluar dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik-shkencor me shumë universitete dhe institucione në Evropë si dhe institucione të arsimit të lartë dhe të artit në vend. Departamenti Aktrim & Teori ka një përvojë shumë të mirë në realizimin e praktikës profesionale me institucionet artistikë në vend.*<br>*Departamenti harton raporte analitike në mënyrë të vazhdueshme mbi rezultatet dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit si dhe për të përmirësuar punën për vitet e ardhshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në | GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Aktrim" është në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit vendas në fuqi për arsimin e lartë, në mënyrë të veçantë me Ligjin 80/2015 si dhe aktet e tjera nënligjore.<br><br>Programi i Studimit Bachelor në Aktrim është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me |

| | |
|---|---|
| përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit te Krediteve.<br><br>Programi ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë dhe përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Programi është i organizuar në lëndë dhe module të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor, ku krahas tyre jepen në mënyrë të hollësishme edhe kreditet përkatëse si dhe të dhëna të tjera mbi tipologjinë e lëndës, semestrin apo vitin akademik kur mund të frekuentohet, ngarkesën semestrale etj.<br><br>*Evidencë 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim "* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i Studimit Bachelor në Aktrim është hartuar për t'iu përgjigjur kerkesave të tregut të punës.<br>Ai synon të zhvillojë në nivele më të larta intelektuale dijen dhe praktikën në fushën e aktrimit. Nëpërmjet tij studentëve iu jepen koncepte e njohuri të përparuara dhe shprehi praktike në fushën e Aktrimit. Për vetë specifikën e programit ai realizohet me metoda mesimdhënie që vënë theksin tek studenti. Ai formon artistë dhe intelektualë që vëzhgojnë dhe hulumtojnë. Ky program synon të zhvillojë kompetenca të larta akademike dhe profesionale.<br>Mësimi dhe realizimet artistike zhvillohen nëpërmjet metodave interaktive dhe terheqese të mësimit, të cilat motivojnë studentët. Situatat mësimore që përdoren lehtësojnë transferimin e njohurive teorike në njohuri praktike dhe modelojnë zgjidhje të problemeve, bazuar në shembujt individualë. Mësimdhënia kërkon më shumë perfshirje të studentëve. Mësimdhënia aktive u lejon studentëve njohjen në thellësi të materialit, zhvillimin e vetëbesimit.<br>Programi ofron një nivel të mirë të njohurive dhe aftësive konceptuale, procedurale dhe transformuese, të bazuar në standardet akademike dhe sociale.<br>Aftësitë dhe njohuritë e përparuar që jep programi, i përgatisin studentët për të zgjidhur probleme të ndërlikuara, duke i aftësuar ata të veprojnë me kompetencë dhe vetebesim në mjedise që kërkojnë ekspertizë të thelluar psikologjike dhe qasje artistike inovative.<br>Programi i Studimit Bachelor në Aktrim, për shkak të specifikës së vet, sidomos në lëndët karakterizuese (Fjala Artistike, Teknika e Të folurit, Interpretim , Monologu), është e konceptuar si një laborator ku krijohet dhe kërkohet realizimi me cilësi i kërkesave të programit.<br>Ky program mundëson që studentët të krijojnë, duke u mundësuar studenteve të krijojnë individualitetin e tyre artistik. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim "*<br>*Evidenca 1.17 Rregullore e vepramtarisë së përgjithshme e Departamentit Aktrim dhe Teori.pdf* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Bazuar në planin mësimor, por edhe në plan programet e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orësh në auditor. Programi i studimit "Aktrim" mbështetet në bazën ligjore për sa i përket veprimtarive formuese, ku lëndët/modulet i gjejmë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Për programin e studimit në fjalë, kurrikula mësimore me disiplina dhe plani mësimor mbështetet në këto kategori:<br>- Kategoria A që përfshin Lëndët Bazë: 33 kredite<br>- Kategoria B që përfshin Lëndët Karakterizuese: 86 kredite<br>- Kategoria C që përfshin Lëndët Ndërdisiplinore /Integruese: 28 kredite<br>-Kategoria D që përfshin Lëndët Plotësuese: 33 kredite<br>- Kategoria E që përfshin Lëndët Përmbyllëse: 10 kredite<br>Kurrikula e këtij programi është hartuar sipas VKM-ës 41 duke mbajtur parasysh që çdo kurs të zërë vendin që i takon në kuadër të veprimtarive formuese.<br><br>*Evidencë 2.1 "PlaniMësimor Bachelor në Aktrimi"* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Duke ju referuar planit mësimor të programit të studimit GVJ konstaton se praktika profesionale është në kategorinë D sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Praktika është e parashikuar me 6 kredite dhe e shtrirë në tri vite akademike, me 30 orë për secilin vit. Referuar edhe Rregullores së programit të studimit, në fund të çdo viti studenti vlerësohet me notë nga pedagogu i caktuar nga FAS për zhvillimin e praktikës mësimore. Kjo praktikë zhvillohet në mjediset e UART apo në mjediset e institucioneve partnere të UART ku studentët zhvillojnë provimet (shfaqje të hapura për publikun).<br>Detyrimet përmbyllëse i përkasin kategorisë E dhe janë më 10 kredite, ku përfshihet Tema Teorike dhe Projekti Artistik.<br><br>*Evidenca 1.2 "VKM nr 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve te studimit*<br>*Evidenca 1.4 "VKMNr. 145, date 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të vecantë UART"*<br>*Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim"* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | UART gëzon status dhe trajtim të veçantë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në zbatim te VKMNr. 145, datë 10.03.2021 'Për dhënien e Statusit të veçantë UART, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë". FAS/UART ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe objektivat institucional duke krijuar të gjitha mundësitë që programet e ofruara të zbatohen në përputhje me standardet kombëtare dhe me eksperiencat më të mira evropiane. Programet e studimit të ofruara nga FAS janë në përputhje me Statutin e UART, Rregulloren e UART, Rregulloren e cikleve të studimit, si dhe Rregulloren e njësisë kryesore. Të gjitha programet e studimit të ofruara në FAS/UART janë me kohë të plotë.<br>Politika e pranimit të studentëve bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë, Ligjin Për Arsimin e Lartë dhe prioritetet e tre Fakulteteve të UART, duke vlerësuar kapacitetet pritëse për çdo vit akademik. Në Universitetin e Arteve pranimi i studentëve kryhet nëpërmjet konkurseve të pranimit, kriteret e të cilave hartohen nga Departamentet, miratohen në Senatin Akademik të UART, dhe dërgohen ne MAS. MAS miraton kuotat e dërguara nga UART, dhe nxjerr Udhëzimin përkatës për zhvillimin e konkurseve të pranimit mbi bazën e rregulloreve dhe kritereve të UART për këtë proces. UART ndjek një politikë mbështetese për studentët me aftësi të kufizuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke parashikuar kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatese. Në A&T/FAS nuk parashikohen kuota per studentët me aftësi të kufizuara. Kjo vjen edhe si pasojë e specifikës së programit. Kurrikulat e lëndëve speciale kërkojnë fizikalitet të lartë brenda dhe jashtë skenës.Për studentët e tjerë A&T/FAS ndjek politika mbështetëse sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br><br>*Evidencë 1.4 "VKMNr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të veçantë UART" Evidence 1.5 "Statuti i UART")*<br>*(Evidencë 1.20 "Rregullorja e UART"*<br>*Evidencë l. 15 "Rregullorja e Ciklit tël të Studimit"*<br>*Evidence 1.16 "Rregullorja FAS"*<br>*Evidencë 2.1 "PlaniMësimor Bachelor nëAktrim "*<br>*Evidenca 2.3 "VSA nr. 15-2023 Miratimiirregulloressëkonkursit 2024 — 2025, FAS" Evidenca 2.4 "VKM 251 27/03/2020 "Përpërjashtiminngapagesatëstudentëve Rome/Ballkano — Egjiptianë"* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të | UART, FAS, A&T është i vetmi institucion që ofron program Bachelor në "Aktrim". |

| | |
|---|---|
| kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 përqind. | |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi i Studimit "Bachelor në Aktrim" është i pajisur me kodifikimin përkatës, në përputhje me fushën e studimit dhe klasifikimet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.05.2022, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".<br>Ky program i ciklit të parë, në përputhje me pikën 2, germa c) të VKM-së së sipërcituar, është i nivelit Bachelor, me një ngarkesë akademike prej jo më pak se 180 kredite ECTS, dhe identifikohet me kodin 63BA.<br>Fusha e gjerë e programit është: 02 – Arte dhe Shkenca Humane;<br>Fusha e ngushtë: 021 – Arte;<br>Fusha e detajuar: 0215 – Arte Muzikore dhe Përformimi.<br>Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe (S) dhe kodi i plotë përkatës i tij është: 63BA0215S.<br><br>**Shënim** : Institucioni është njoftuar për përfundimin e procesit të kodifikimit më 22.01.2025, sipas Evidencës 1.22.2. Institucioni duhet të bëjë kodifikim e lëndëve për vitin e ardhshëm akademik.<br><br>*Evidenca 2.5 "VKM Nr. 310 11/5/2022 Specifikimet dhe Permbajtjet e Kodifikimit te Programeve të Studimit"*<br>*Evidenca 1.22.2_Shkresa e Zv. Rektorit dt 22.10.2025 Mbi kodifikimin përfundimtar të programeve të studimit në UART, përcjellje e shkresës së MAS Njoftim mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit.* |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Departamenti Aktrim & Teori, FAS, UART, nuk ofron programe të përbashkëta me asnjë institucion të arsimit të lartë, lartë, vendas dhe të huaj. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Bachelor në Aktrim është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e miratuara nga institucioni dhe specifikën e programit. Programi i Studimit Bachelor në Aktrim është hartuar për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Ai synon të zhvillojë në nivele më të larta intelektuale dijen dhe praktikën në fushën e aktrimit.* |

| | |
|---|---|
| | *Programi i Studimit përmban objektivat formuese, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë përkatës, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS, vlerësimin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, detyrimet përmbyllëse. Praktika profesionale e shtrirë në tri vite akademike, me 30 orë për secilin vit, mundëson përftimin e aftësive aktoriale të studentëve.*<br><br>*Politika e pranimit të studentëve bazohet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë dhe në pranimin e më të talentuarve, bazuar në kritere të hartuara në departament dhe miratuar në senat.*<br>*UART ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | UART ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.17, datë 24.03.2022 që akrediton në formë institucionale, me vlefshmëri 6 vite, për periudhën nga 24/03/2022 deri në 23/03/2028.<br><br>FAS (Fakulteti i Artit Skenik) si njësi përgjegjëse për programin Bachelor në Aktrim ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me objektivat e tij akademike dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Fakulteti i Artit Skenik si njësi kryesore e UART përbëhet nga: Departamenti Aktrim dhe Teori (A&T), Departamenti Regji, Regji Filmi dhe TV, Departamenti Skenografi-Koreografi. Funksionet e tyre përcaktohen në rregulloren e fakultetit dhe në rregulloret e departamenteve.<br><br>FAS — Për FAS, numri i stafit akademik me kohë të plotë i ndarë sipas Departamenteve (2024-2025) paraqitet si më poshtë: 44 pedagogë<br>Departamenti A&T — 13 pedagogë<br>Departamenti RRFTV— 20 pedagogë<br>Departamenti S&K 11 pedagogë<br>Stafi pedagagogjik i Aktrim&Teori dhe kualifikimet e tyre paraqiten si më poshtë:<br>*Personeli Akademik Efektiv*,13 pedagogë gjithsej prej të cilëve :<br>- 3 (tre) Profesorë; |

| | |
|---|---|
| | -2(dy) Prof.Assoc.Dr,<br>- 2 (dy) Profesorë te Asociuar;<br>-3 (tre) Doktor;<br>-2 (dy) Asistent Lektorë, te dy në process Dr<br>- l(një)Docentë<br>*Personeli Akademik me Kontratë*:<br>1 (l) Profesor;<br>*Personeli akademik me kohë te pjesëshme* , gjithsej 11 (njembedhjetë) prej të cilëve)<br>-1 (një) Profesor ( Profesori ka filluar me kohe të plotë pranë Departamentit Aktrim dhe Teori, në simestin e dytë të vitit akademik 2024-2025 )<br>-1 (një) Profesor Asociuar Dr<br>- 3 (tre) Dr<br>- 6 (gjashtë) Asistent Lektorë, nga të cilët 2 janë në process Dr<br><br>***Të dhëna për Departamentin e Aktrimit dhe Teoris:*** |

| **Tituj/ grada** | **2022 – 2023** | | **2023 – 2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** |
| Prof. | 5 | 1 | 4 | 1 | 3 | 1 |
| Prof. Asoc. | 4 | 1 | 4 | 1 | 4 | 1 |
| Dr./PhD. | 5 | 4 | 5 | 4 | 4 | 3 |
| Lektor | 2 | - | 2 | - | 2 | - |
| As.Lektor | - | 3 | - | 5 | - | 6 |
| **Totali** | **16** | **9** | **15** | **11** | **13** | **11** |

| | |
|---|---|
| | Evidenca 1.27_Tabelat e stafit akademik FAS.pdf<br>Evidenca 2.7 Vendim i BA te ASCAL per Akreditimin Institucional te UART.pdf |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik | Referuar RVB dhe tabelave përmbledhëse konstatohet se në secilën njësi kryesore në UART funksionojnë struktura ndihmëse me karakter akademik/administrativ, të cilat përcaktohen në strukturën dhe në Rregulloren e njësive kryesore, duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.<br>Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai |

| | |
|---|---|
| /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Kjo kategori plotësohet me personel i cili ka qenë më parë student në po këtë fakultet dhe mundësisht në po të njëjtin program studimi. FAS angazhon 8 (tetë) personel ndihmës akademik /administrativ.<br><br>*Evidencë 1. 16 "Rregullorja e FAS.*<br>*Evidencë 1.5 "Statuti i UART"*<br>*Tabela 1 në Anekset e RVB*<br>*Evidenca 4.5_Listë e stafit ndihmës akademik AKTRIM.pdf* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Veprimtaria mësimore e njwsisw bazw A&T është organizuar nëpërmjet grupeve mësimore. Janë ngritur dy grupe mësimore: Grupi i Aktrimit dhe Grupi i Teorisë, që mbulojnë programet e të dy cikleve të studimit.<br>Për Programin e Studimit "Bachelor në Aktrim", njësia bazë përgjegjëse ka emëruar një Koordinator Programi, me vendim të Dekanit të Fakultetit të Arteve Skenike . Koordinatori është i ngarkuar me mbikëqyrjen e përgjithshme të ecurisë akademike të programit, përfshirë zhvillimin e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat dhe standardet e përcaktuara në planin mësimor.<br><br>Sipas përcaktimeve të Rregullores për veprimtarinë e përgjithshme të Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë, ky funksion ushtrohet nga përgjegjësi i njësisë bazë.<br><br>(Evidencë 1. 17) Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e Departamentit Aktrim dhe Teori.pdf<br>(Evidenca 2.6) "Drejtuesit e grupeve mësimore në FAS" |
| **Konkluzion** | *UART ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik me vlefshmëri 6 vite, deri në 23/03/2028. Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti A&T në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë. A&T/FAS, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Aktrim" përmbush të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti ka stafin e duhur të kualifikuar dhe në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi. Personeli akademik i angazhuar ka aftësitë dhe kualifikimet e duhura për realizimin e programit.*<br>*Departamenti është i organizuar në dy grupe mësimore. Drejtuesi i njësisë bazë është përgjegjës për zbatimin e programit të ciklit të parë dhe ndjek nga afër ecurinë e tij. Ka angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ. Funksionet e tyre përcaktohen në rregulloren e fakultetit dhe në rregulloret e departamenteve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Fakultetin e Artit Skenik, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në Aktrim, disponon dhe ka vënë në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat gjenden të reflektuara në Rregulloren e UART, Rregulloren e FAS, Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e programit të studimit, Planin mësimor dhe më tej në syllabuset e lëndëve këtij programi të grupuara në përputhje me kategoritë e veprimtarive formuese.<br>Këto dokumenta janë hartuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".<br>Programi i studimit ka natyrë specifike dhe syllabuset e tij kanë elementë dhe përbërje të veçantë. Në hartimin dhe zbatimin e programit të lëndës mbahen në konsideratë dy parime themelore: 1. Njohuritë bazike të nevojshme që duhet të ketë studenti për përvetësimin e programit përkatës.<br>2. Shmangien e përsëritjeve të tematikave të veçanta ndërmjet disiplinave të ndryshme apo të përafërta. Departamenti A&T ka kapacitetet pedagogjike dhe strukturore për ofrimin e këtij programi studimi.<br><br>*Evidencë 1.4 "VKMNr. 145, date 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit të UART"*<br>*Evidence 1.15 Rregullore mesimore e ciklit te pare te studimeve Bachelor ne UART.pdf*<br>*Evidencë I. 17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidence 1.18 "Rregullorja e Programit të StudimitAktrim"*<br>*Evidence 2.1 Plani Mésimor Bachelor ne Aktrim"* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni I nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të | Programi i studimit Bachelor në "Aktrim" është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra.<br><br>Bazuar në legjislacionin në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.<br><br>Ky Program është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite. GVJ vlerëson shtrirjen e lëndëve karakterizuese të këtij programi |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | studimi si Fjala artistike, Teknika e të folurit, Interpretim monologu (aktrim) si dhe të praktikës profesionale( 6 kredite) në tri vite studimesh duke mundësuar një aftësim teorik dhe praktik artistik të studentëve. Gjithashtu detyrimet përmbyllëse (kategoria E) me 10 kredite përmbajne Temë Teorike dhe Projekt Artistik.<br>Programi mbështetet në planin mësimor i cili gjen zbatim nëpërmjet programeve lëndore përkatëse. Plani mësimor paraqet në mënyrë të hollësishme një sërë informacionesh që lidhen me ngarkesën mësimore, titullin eveprimtarisë formuese, kategorinë e veprimtarisë, frekuentimin, kreditet e lëndëve, orët mësimore në javë, semestrin kur mund të frekuentohet një lëndë e caktuar, numrin e orëve në auditor ose për studim individual. Në planin mësimor specifikohen edhe instrumentet e vlerësimit të njohurive Plani mësimor është hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.<br><br>*Evidence 1.2 "VKMNr. 41, Dt. 24.01.2018"*<br>*Evidencë 2.2_Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim 1.pdf*<br>*Evidencë 2.2_Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim 2.pdf*<br>*Evidencë 2.2_Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim 3.pdf*<br>*Evidencë 2.2_Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim 4.pdf*<br>*Evidencë 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrimi* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit "Aktrim" funksionon në zbatim të Rregullores së UART, Rregullores së Fakultetit, Rregullores së Departamentit si dhe Rregullores së programit të studimit, ku specifikohet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nga komisionet *ad-hoc* që ngrihen kur ka kërkesa për transferime. Po ashtu studentët kanë mundësi të informohen rregullisht mbi këto kritere edhe përmes faqes zyrtare të UART si dhe nga njoftimet e ndryshme që afishohen në mjediset e universitetit.<br>Pranimi i kandidatëve në Programin e Studimit "Bachelor në Aktrim" pranë Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë , Fakulteti i Arteve Skenike , realizohet përmes një konkursi përzgjedhës, i cili bazohet në parimet e meritës dhe aftësive artistike. Programi ka një numër të kufizuar pranimesh dhe përzgjedhja bëhet në përputhje me kapacitetet fizike dhe burimet njerëzore në dispozicion, si: disponueshmëria e personelit akademik dhe ndihmësakademik, raporti pedagog–student, infrastruktura didaktike dhe logjistike etj. Kriteret e pranimit përcaktohen nga Departamenti A&T dhe bëhen publike në mënyrë transparente. Përzgjedhja e studentëve fitues |

| | |
|---|---|
| | kryhet nga struktura përkatëse e A&T dhe miratohet nga Dekani i FAS, në përputhje me kriteret e miratuara zyrtarisht.<br>Gjithashtu, proceset e transferimit të studimeve dhe njohjes së krediteve janë të rregulluara nga dokumentacioni normativ i Universitetit të Arteve (UART) dhe i Programit të Studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. UART ofron mundësi për transferimin e studentëve brenda programeve të së njëjtës cikël studimi, si në kuadër të vetë institucioni, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, sipas kuotave të miratuara dhe standardeve të njohura ligjore<br><br>*Evidence "Statuti i UART, neni 86, 87, 88, 89"*<br>*Evidence I.17 "RregulloreDepartamentit Aktrim&Teori"*<br>*Evidenca 2.8 "Manual i transferimit të studimeve në UART"* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit Brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Për programin e studimit Bachelor në "Aktrim", pjesë përbërëse e dosjes së programit të studimit "Aktrim" janë edhe programet lëndore (syllabuset e detajuara), të cilat mbështesin planin mësimor të këtij programi studimi. Ato përmbajnë gjithë informacionin që i nevojitet studentëve mbi lëndët përkatëse. Këtu përfshihen: përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit, objektivat e lëndës, konceptet themelore që do të trajtohen, kalendari javor me temat përkatëse, forma e kontrollit të dijeve si dhe literatura përkatëse, që është specifike për çdo lëndë. Këto syllabuse përmbajnë edhe informacion orientues si më poshtë: emrin e pedagogut të lëndës, ngarkesën në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (1 ECTS = 25 orë studimore), numrin e orëve në auditor dhe orëve për studim individual jashtë auditorit, tipologjinë e lëndës, vitin akademik dhe semestrin akademik kur mund të ndiqet lënda, llojin e lëndës: e detyruar ose me zgjedhje si dhe adresën e postës elektronike të pedagogut të lëndës.<br>Syllabuset (programet lëndore), ku përfshihen objektivat dhe qëllimet, temat, mënyra e vlerësimit dhe rregullat e provimit u prezantohen dhe shpjegohen studentëve në fillim të zhvillimit të kursit nga pedagogu përkatës. Në takimin me studentët GVJ u informua për një bashkëpunim të ngushtë pedagog me studentë, bazuar në specifikën e programit, që i ndihmon ata të njohin mirë përmbajtjen e lëndës dhe objektivat e synuara.<br>Në ciklin e parë studentët i nënshtrohen Praktikave Profesionale që janë lëndë e ndërthurur teorike dhe praktike ku secila orë mësimore zhvillohet në terren. Kryesisht në mjediset në dispozicion të FAS/A&T (studio, atelie, salla) ose në mjedise te partnerëve me të cilët UART ka marrëveshje bashkëpunimi.<br>Syllabuset rishikohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe hartohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. |

| | |
|---|---|
| | *Evidencë 2.2_Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim 4.pdf*<br>*Evidencë 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrimi — Praktika Profesionale*<br>*Evidencë 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim "*<br>*Evidence 1.29 "Marrëveshje bashkëpunimi të UARTC me-Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit"* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, GVJ vëren se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron.<br>Në mbledhjet e Departamentit A&T, si njësi bazë e FAS, realizohen diskutime rreth mundësive të përmirësimit të Programit të Studimit, kurdo që shihet e nevojshme. Në takimet e departamentit me stafin me kohë të plotë dhe të pjesshëm, me partnerë të jashtëm, me studentët e Alumni mblidhen ide të reja, nevojat për përmirësim dhe propozime për ndryshime që përmirësojnë programet mësimore në përputhje me nevojat e tregut. Referuar legjislacionit në fuqi si dhe Statutit dhe Rregullores së UART, ndryshimet në planin mësimor të Programit të Studimit realizohen me Vendim të Senatit Akademik të IAL. Si është tashmë praktikë e konsoliduar ndër vite në UART, në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet apo përmirësimet e mundshme dhe arkivohet dosja e plotë.<br><br>*Evidencë 1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë tëstudimit*<br>*Evidence I. 18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrimi*<br>*Evidenca 2.9 "Rishikimi i Programeve të Studimit në vitet 2022 2024"* |
| **Konkluzion** | *FAS dhe Departamenti Aktrim Teori disponojnë informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe funksionimin programit të studimit Bachelor në Aktrim. Ato përcaktojnë, strukturën akademike që ofron Programi i Studimit dhe strukturat e tjera mbështetëse, objektivat e programit dhe kompetencat e formimit, kriteret hyrëse, planin mësimor, programet lëndore dhe procedurat e diplomimit.*<br>*Programi i Studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës profesionale, janë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.*<br><br>*Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin të detajuar ku përfshihen kreditet, përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore që do të trajtohen, kalendarin javor me temat përkatëse, formën e kontrollit të dijeve si dhe literaturën përkatëse. Veprimtaritë formuese janë të grupuara në kategori që variojnë nga* |

| | |
|---|---|
| | *A-E, të ndara në semestër dhe sipas ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit.*<br>*Syllabuset hartohen nga pedagogët përgjegjës në fillim të semestrit dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë, i cili merr miratimin e grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup.Studentët njihen me përmbajtjen e lëndës, mënyrën e organizimit dhe vlerësimit nga pedagogu përkatës. Në çdo vit akademik miratohen e firmosen syllabuset e lëndëve nga Përgjegjësi i Departamentit dhe dosja arkivohet.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për thellimin e njohurive të e studentëve. Përzgjedhja e lëndëve në programin e studimit Bachelor në "Aktrim" u mundëson studentëve njohuri të thelluara dhe aftësi për të vazhduar më tej studimet në Ciklin e dytë ose për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, në një larmi pozicionesh ku më i rëndësishmi dhe më i kërkuari është pozicioni i aktorit në teatër. Objektivat dhe qëllimi që parashtrohet në secilin prej lëndëve që ofrohen, si edhe praktika mësimore/profesionale, janë përcaktuar që studentët të zhvillojnë aftësi në fushën e kërkimit artistiko shkencor duke iu përshtatur pritshmërisë dhe nevojave për punësim ose vazhdim të mëtejshëm të studimeve të studentëve.<br>Personeli akademik, 81% e personelit me kohë të plotë të A&T është formuar në auditorët e FAS , është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve. GVJ në takimin me studentët u informua për përkushtimin e plotë të pedagogëve për zhvillimin artistik e profesional të tyre, si dhe trajtimin e tyre jo thjesht si studentë, por si bashkëaktorë.<br><br>*Evidencë 1.2 "VKMNr. 41, Dt. 24.01.2018/shtojca 1, Tabela 2*<br>*Evidencë .1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim '*<br>*Evidencë 1.27 "Tabelat e stafit akademik FAS"* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, | GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e |

| | |
|---|---|
| shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional.<br><br>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit "Aktrim " vihet re se lëndët dhe shpërndarja në vite dhe semestra është realizuar në atë mënyrë që studentët të kenë mundësi të aftësohen me njohuri, kompetenca dhe shkathtësi artistike, për t' i bërë konkurues ne një treg pune giithnjë e më dinamik. Programi i Studimit synon t'u ofrojë studentëve krijimin e bazave dhe njohurive specifike profesionale dhe shkencore në Aktrim dhe në përshtatje me tregun e punës. Bazuar objektivave kryesore të programit si : Rrënjosje të njohurive bazë, koncepteve, aftësive teorike dhe praktike mbi Aktrimin skenike; përgatitja e studentëve për formimin e kompetencave dhe aftësive që iu korrespondojnë nivele të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit në fushën e aktrimit të teatër ose spektakle të ndryshme; trajnimi për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të krijimit dhe kërkimit programi përfshin lëndë që realizojnë këto objektiva. Në lëndët e përfshira planifikohet veprimtari praktike, krahas praktikës profesionale e vlerësuar më 6 kredite. |
| **Kriteri 3.**Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Struktura e Programit të Studimit përfshin lëndë që i pajisin studentët me aftësi dhe kompetenca të qëndrueshme, zhvillojnë aftësitë e tyre artistike dhe mundësojnë vazhdimin e studimëve në Ciklet pasardhëse.<br>Struktura e programit Bachelor në Aktrim është tërësisht në përputhje me profilin e programit Bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>Lëndët e përgatitjes shkencore artistike (Kategoria B) si Bazat e Mjeshtrisë së Aktorit, Mjeshtri Aktori Dialogu, Mjeshtri Aktori-Figurë Artistike, Teknika Produksioni Skenik Teknika e të folurit, Fjala Artistike, Interpretim Monologu krijojnë bazat dhe formojnë një aktor të aftë për punësim ose për studime të mëtejshme.<br>Lëndët e përgatitjes metodologjike dhe kulturës së përgjithshme dhe emërtimi i tyre (Moduli A), si dhe ato ndërdisiplinore/integruese (Moduli C) në këtë program studimi janë në përputhje me profilin e këtij programi Bachelor , dhe pajisin studentët në aftësi e kompetenca në një fushë të gjerë dijesh.<br>Ngarkesa në kredite dhe shpërndarja e drejtë në vite, semestra dhe lëndë siguron një ngarkesë të balancuar përgjatë gjashtë semestrave akademikë dhe mundëson pajisjen e studentëve me aftësi profesionale artistike, kompetenca dhe formim profesional në fushën e artit. Kurrikula është mjaft e perafërt edhe me programe të ngjashme ndërkombëtare të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë, zbatuese të procesit të Bolonjës.<br>Raporti teori-praktikë në këtë program studimi është në përputhje me profilin e programit bachelor |

| | |
|---|---|
| | *Evidencë 2.2 Kurrikula e Programit të Studimi*<br>*Evidencë 2.1 Plani Mësimor Bachelor në Aktrim* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Në programin e studimit Bachelor në Aktrim, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi. Në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues. Ky raport vihet re jo vetëm në raportin midis lendëve në planim mësimor, por edhe midis vetë veprimtarive teorike dhe praktike në brendësi të secilës lëndë. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë transferim të studimeve dhe mobilitet te studentëve në kuadër të projekteve si Erasmus +, falë kjo edhe punes së vazhdueshme është bërë ndër vite në drejtim të përafrimit të këtij programi studimi me programet e tjera të ngjashme që zhvillohen në vendet e BE-së si dhe objektivave strategjikë te UART të cilat kanë si prioritet: mobilitetet, aktivitetet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe rritjen dhe konsolidimin e partneritetit me vende te BE-së.<br><br>Evidencë 1.2 "VKM nr 41, datë 24.01.2018 "Për elementete programeve të studimit<br>*Evidencë 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim*<br>*Evidencë 2.1 "Plani Mësimor Bachelor nëAktrim"*<br>*Evidencë 1.28 "UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+"* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit Aktrim & Teori , GVJ evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik.<br><br>Syllabuset e lëndëve përditësohen rregullisht, duke përfshirë edhe literaturën më të re të publikuar gjatë pesë viteve të fundit, aty ku është e zbatueshme. Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë monitoron vazhdimisht performancën dhe cilësinë e programeve të studimit, duke u bazuar në analizën e ecurisë së tyre dhe duke marrë në konsideratë mendimet dhe vlerësimet e pedagogëve si dhe të studentëve .<br>Në bazë të këtyre feedback-eve, njësia bazë ndërmerr masa konkrete për përmirësimin dhe përditësimin e mëtejshëm të syllabus-eve. Të gjitha syllabus-et për këtë program janë hartuar në |

| | |
|---|---|
| | përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, dhe janë të firmosura nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit përkatës.<br><br>**Shënim**: Nga kontrolli i syllabuseve, GVJ konstaton se literatura në disa raste nuk është e përditësuar. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me stafin akademik, vihet re se edhe në këto lëndë, pedagogët përgjegjës përditësojnë literaturën plotësuese me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive.<br><br>*Evidence 1.2 "VKM nr 41, datë24.01.2018 "Për elementete programeve të studimit"*<br>*Evidence 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim "*<br>*Evidencë 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrimi"* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i Studimit Bachelor në Aktrim synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara, kompetenca, aftësi teorike dhe praktike mbi aktrim në skenë si dhe fitimin e njohurive dhe kompetencave për të realizuar kërkim shkencor në fushën e arteve skenike dhe aktrimit. Struktura e programit, raporti teori praktike, qëllimet dhe objektivat e secilës lëndë të këtij programi në përputhje me objektivat kryesore të programit të studimit sigurojnë arritjen dhe përftimin e kompetencave të synuara.<br>Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se pedagogët që zhvillojnë këtë program, janë aktorë më përvojë të cilët e kanë përfshirë këtë përvojë në program dhe në zhvillimin e procesit mësimor. Studentët theksuarn se puna intensive individuale me pedagogët, ose në grupe të vogla e bën të realizueshëm dhe zhvillues këtë PS.<br><br>*Evidence 1.5 "Statuti i UART"*<br>*Evidencë 1.15 "Rregullorja e ciklit te I-rë të studimit"*<br>*Evidence 1.18 "Rregullorja e Programit të StudimitAktrim"*<br>*Evidencë 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim "* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programit të Studimit Bachelor në Aktrim mundëson vijimin e mëtejshem të studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë si brenda UART/FAS ashtu edhe në institucione artistike në rajon apo në institucionet artistike të vendeve europiane.<br><br>Gjithashtu, përmbajtja e tij i pajis studentët më aftësi e kompetenca të kërkuara në tregun e punës.<br><br>Gjatë takimeve të zhvilluara GVJ u informua se studentët që ndjekin programet e ofruara nga Departamenti i A&T FAS janë punësuar në |

| | |
|---|---|
| | shumë institucione artistike dhe kulturore të vendit, kombëtare apo lokale. Një pjesë e mirë e tyre janë të punësuar në: Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar Eksperimental, Radio Televizionin Shqiptar, Teatrin e Metropolit, si dhe në shumë radio televizione kombëtare dhe lokale.<br><br>*Evidencë 1.5 "Statuti i UAR*<br>*Evidencë 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit"*<br>*Evidencë l. 18 "Rregullorja e Programit te Studimit Aktrim*<br>*Evidence 2.2 "Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor* |
| **Konkluzion** | *GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Lëndët në program përkojnë me objektivat formuese të tij dhe sigurojnë vazhdimësi si në përgatitjen e studentëve për tregun e punës, për studime në ciklet e tjera.*<br>*Struktura e programit, raporti teori praktikë, praktika profesionale dhe mënyra e vlerësimit garantojnë përftimin e kompetencave të synuara. Njëkohësisht, ngjashmëria e tij me programe të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, mundëson studentët të transferojnë studimet e tyre.*<br>*Vit pas viti programi i studimit Bachelor në "Aktrim" përditësohet bazuar në nevojat e tregut, diskutimeve dhe analizave në departament . Kjo reflektohet në syllabuse, përditësimi i të cilëve bëhet çdo vit, duke u pasuar me literaturë të re. Syllabusat azhornohet edhe me literaturën e dalë në qarkullim në 5 vitet të fundit (atje ku është e aplikueshme), theksohet në RVV dhe në takimet e bera.*<br><br>***Sugjerojmë*** *të rishikohet literatura në syllabuset e lëndëve duke u përditësuar me literaturë të viteve të fundit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Në funksioin të përmirësimit dhe përshtatjes së programit me kërkesat e tregut të punës FAS, ashtu si dhe Departamenti A&T kanë zhvilluar gjatë këtyre viteve një sërë aktivitetesh konsultative.<br><br>Takimet me Alumni kanë qëne të frutshme, sepse një pjesë e tyre është personel akademik me kontrat në FAS/A&T që punojnë në institucione kulturore të kryeqytetit dhe prezantojnë më mirë kërkesat e tregut.<br><br>Ofrimi i tre cikleve të studimit në këtë Fakultet në tri cikle studimi ka kërkuar rishikimin e kurrikulave.<br><br>Pjesë e punës që UART/FAS synon tëbëjë (për rrjedhojë edhe A&T) është edhe reformimi dhe përfshirja e diplomave që lëshon institucioni për profesionet e rregulluara edhe për profilet artistike profesionale, tashmë si një nevojë e përfshirjes së studentëve për tregun e punës (P.sh. Në ciklin e dytë kjo është realizuar vetëm për pjesën e mësuesisë të diplomave të lëshuara nga Fakulteti).<br><br>Gjithashtu procesi i përmirësimit të programit vjen edhe prej vlerësimit që bëjnë vetë studentët përmes pyetësorëve të zhvilluar në fund të secilit semestër prej NJSBC. Ky vlerësim bëhet për ecurinë e programit brenda institucionit, kështu që dhe përmirësimi fokusohet më shumë në përmirësimin e literaturës, cilësisë së mësimdhënies, ndërveprimit pedagog-student, metodave dhe teknikave të vlerësimit, angazhimin e stafit në këshillimin e studentëve etj.<br><br>*Evidence 1.5 "Statuti i UART"*<br><br>*Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në UART, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale konform Statutit dhe Rregullores së UART. Si edhe u konstatua gjatë takimeve të GVJ, përtej përfaqësimit në këto organe, institucioni përfshin opinionet e studentëve në diskutimet e brendshme të njësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programeve që ofrohen.<br>FAS mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar (ALUMNI), duke ndjekur ecurinë, punësimin, arritjet etj. FAS mbledh të dhëna të rëndësishme për punësimin e tyre në bashkëpunim edhe me Sektorin mesimor dhe organizon aktivitete të dedikuara për ALUMNI.<br>ALUMNI ka funkionuar prej vitesh në UART, dhe funksionon nëpërmjet kontakteve nga FAS por edhe me lidhje e bashkëpunim midis PAE dhe PAK, nëpërmjet pjesëmarrjes në vepra skenike apo filmike të realizuara në UART ose jashtë tij. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">Departamenti i A&T mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.<br><br>Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve/ të teatrit pedagogëve të FAS, studentëve aktualë dhe iSh studentëve Evidenca 2. 11 "Cmime, vlerësime dhe dëshmi te ish studentëve FAS"</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</td><td colspan="4">FAS dhe Departamenti A&T i ka dhënë një rëndësi të madhe bashkëpunimit me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve të tij. Bazuar në informacionin që vjen nga ky bashkëpunim bëhet përshtatja dhe përditësimi i programit.<br>Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me: Këshillin e Qarkut Tiranë, Radio Televizionin Shqiptar, Teatrin Kombëtar, Universitetin e Tiranës, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës; Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër; Shkollën kombëtare artistike "Jordan Misja", Teatrin e Metropolit, etj. Një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi janë realizuar edhe në kuadër të publikimit "Pakti për Universitetin".<br>GVJ konstaton se bashkëpunimi me këto institucione publike edhe private ka mundësuar plotësimin e nevojave të studentëve për funksionimin dhe realizimin e programit te studimit.<br><br>Evidencë 1.29 "Marrëveshje bashkepunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit"</td></tr>
<tr><td>Konkluzion</td><td colspan="4">A&T/FAS analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpuntorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik. Me qëllim përmirësimin e programit të studimit Bachelor në Aktrim , A&T/FAS mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dh studentëve aktualë dhe merr prej tyre propozime për përditësimin e programit të studimit. Kjo realizohet duke siguruar pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve në diskutime të hapura për të përmirësuar aspektet praktike të lidhura me formimin e studentëve. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e tyre. A&T/FAS i jep një rëndësi të madhe bashkëpunimit me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve të tij. Bazuar në informacionin që vjen nga ky bashkëpunim bëhet përshtatja dhe përditësimi i programit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, GVJ véren se transmetimi i dijeve në auditor realizohet në mënyra të ndryshme të miratuara nga dokumente të përcaktuara nga Institucioni dhe në përshatje me veçantinë e këtij Fakultei dhe Programi.<br>Format e mësimdhënies për Programin e Studimit Bachelor në Aktrim janë: leksionet; seminaret; ushtrimet; detyrat e kursit; projektet artistike dhe praktika profesionale.<br>Puna individuale është vlerësimi i punës së bërë individualisht nga studenti përkundrejt veprave dhe materialeve artistike të dhëna paraprakisht nga pedagogu përkatës; Përdorimi i Projekti artistik ndihmon studentët për aftësim aktorial si dhe nga pikëpamja teorike. Projektet shfaqen dhe vlerësohen në fund të semestrit. Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare janë format kryesore të vlerësimit të studentëve zhvilluar me vepra konkrete artistike.<br>Në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim perveç lëndëve me karakter tërësisht teorik (Modulet A dhe C) lëndët e formimit profesional (Moduli B) nuk zhvillohen në formën e leksionit klasik.(leksione speciale) Mësimdhënësi është i përfshirë fizikisht në ndërveprim konkret me studentin duke ilustruar në praktikë të gjitha parimet që ka shpjeguar më parë teorikisht.<br>Veçori e mësimdhënies është ndërtimi i një procesi mësimor i cili përshtatet në mënyrë te drejtpërdrejtë dhe individuale me studentin. Në takimin me studentë dhe më pedagogë ,GVJ konstatoi se kjo formë vlerësohej maksimalisht nga studentët dhe pedagogët, sepse |

| | |
|---|---|
| | ndihmon për realizim cilësor të programit dhe për zhvillimin profesional dhe shoqërortë studentëve.<br>Zhvillimi i orëve të hapura të organizuara nga pedagogët e lëndëve në bashkëpunim me studentët aktivë, si dhe me ish-studentët e diplomuar në këtë program është pjesë organike këtij programi studimi. Këto orë synojnë të shërbejnë si platformë demonstrimi dhe reflektimi mbi procesin mësimor dhe përvojën praktike në fushën e aktrimit.<br><br>*Evidencë 1.4 "VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit te vecantë UART"*<br>*Evidencë 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrin*<br>*Evidencë 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit"*<br>*Evidencë 2.2 Kurrikula e Programit te Studimit Bachelor në Aktrim "* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Në takimin me studentët e këtij programi studimi, por edhe me stafin akademik të angazhuar në këtë program, vërehet një frymë bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve. Lektorët e angazhuar në programin Bachelor në "Aktrim" zbatojnë metoda të ndryshme të mësimdhënies,<br>Studentët ndërgjegjësohen për objektivat e të nxënit dhe mënyrën e organizimit të mësimit dhe të vlerësimit. Puna është individuale ose ne grupe të vogla. Përmbajtja e mësimit përforcohet përmes detyrave të ngarkuara nga pedagogu për punimin individual, ushtrimeve dhe ofrimit të literaturës për konsultim jashtë orarit të mësimit.<br>Në kuadër të zbatimit tw metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe nxënies, Fakulteti i Artit Skenik zbaton me sukses projektet artistike të përbashkëta si një formë alternative dhe efikase e procesit mësimor. Këto projekte përfshijnë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit akademik të FAS-it dhe realizohen në bashkëpunim me departamente të tjera të institucionit si dhe me struktura të jashtme, përfshirë trupa dhe teatro profesionistë. Studentët nxiten të angazhohen në aktivitete të karakterit krijues si shfaqje teatrore, programe variete dhe koncerte të fjalës artistike. Këto veprimtari përbëjnë një komponent integral të praktikave bashkëpunuese të Departamentit të Aktrimit dhe Teorisë, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe interaktiv në procesin e mësimdhënies.<br><br>*Evidencë 1.5 "Statuti i UART" neni 63*<br>*Evidencë I. 16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS"*<br>*Evidencë 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë te studimit"*<br>*Evidenca 3.1 "Takimimefigura të skenës dhe ish-pedagogë dhe Alumni "*<br>*Evidencë 2.10 "Dosja e repertorit tëshfaqjeve/filmave të pedagogëve te FAS, studentëve aktualë dhe ish studentëve"* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Institucioni mbështet dhe angazhohet për përparimin akademik të personelit. Një formë e mbështetjes është pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh si dhe organizimin e trainimeve dhe masterclass-e.<br>Me qëllim për të garantuar një mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore, institucioni, nëpërmjet drejtuesve të strukturave akademike dhe vetë anëtarëve të stafit pedagogjik, promovon dhe inkurajon pjesëmarrjen aktive të këtij stafi në veprimtari profesionale dhe akademike si: trajnime, leksione të specializuara (masterclass-e), shkëmbime ndëruniversitare dhe aktivitete të tjera me karakter artistik e shkencor.<br>Fokusi kryesor i këtyre angazhimeve qëndron në përvetësimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, qasjeve të reja vlerësuese, si dhe përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit akademik.<br>Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë (A&T), pranë Fakultetit të Arteve të Skenës (FAS), mbështet vazhdimisht zhvillimin profesional të personelit akademik, përmes orientimit dhe zbatimit të praktikave të avancuara psiko-pedagogjike dhe didaktike, të cilat përputhen me standardet e arsimit të lartë.<br>Njëkohësisht, A&T nxit dhe lehtëson përfshirjen e stafit në programe të mobilitetit ndërkombëtar si Erasmus dhe Erasmus+, me qëllim përfitimin nga përvoja dhe ekspertiza e institucioneve partnere jashtë vendit.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART" neni 68*<br>*Evidenca 3.2 "Aktivitete të Erasmus/Erasmus+ "*<br>*Evidenca 3.3 "Aktivitete të ëorkshopeve/masterklasave2022-2024"*<br>*Evidenca 3.4 "Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencor të stafit Aktrim "*<br>*Evidenca 3.5 "Dosja e studentëveaktualetëdoktoraturësngastafiAktrim* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik I angazhuar në mësimdhënien në program është competent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interactive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e | Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim, është i kualifikuar në fushën e tij/saj të studimit dhe përveç titujve dhe gradave shkencore ka edhe eksperienca dhe kualifikime të rëndësishme të krijuara nga takime ose aktivitete të rëndësishme artistike kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Në sajë të kualifikimeve të larta dhe angazhimit të vazhdueshëm të stafit akademik me zhvillimet më të fundit në fushën e arteve dhe edukimit, në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim zbatohet me efikasitet një ndërthurje e balancuar mes metodave tradicionale dhe atyre bashkëkohore të mësimdhënies. Personeli akademik në këtë program zotëron kompetenca të plota në interpretimin dhe transmetimin e njohurive dhe koncepteve, duke aplikuar metoda të ndryshme pedagogjike të përshtatura me tematikat dhe objektivat specifike të planit mësimor.<br>Bazuar në të dhënat tabelore për tre vitet e fundit akademike, rezulton se Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë (A&T), pranë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Fakultetit të Arteve të Skenës (FAS), ka angazhuar mesatarisht 66% të stafit akademik me kohë të plotë në këtë program studimi, të cilët mbulojnë rreth 87% të ngarkesës mësimore në auditor. Duke marrë parasysh natyrën specifike të procesit mësimor-artistik në FAS, si dhe karakteristikat e veçanta të formimit artistik, në qendër të të gjithë veprimtarisë mësimore vendoset studenti. Ky proces synon të zhvillojë tek studentët mendimin krijues dhe kritik, si dhe të forcojë autonominë dhe ndjenjën e përgjegjësisë personale – elementë të pazëvendësueshëm për formimin profesional në fushën e arteve skenike.<br><br>Gjatë takimit me studentët e programit GVJ konstatoi se ata shprehen pozitivisht për njohuritë që kanë fituar, për përfshirjen e tyre në jetën e institucionit, për mbështetjen që kanë gjetur në institucion për probleme të ndryshme dhe për trajtimin me respekt nga stafi akademik.<br><br>*Evidenca 3.6 "Lista e realizimeve artistike të stafit Aktrim 2022-2024 "*<br>*Evidenca 3.4 "Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencor të stafit të Departamentit A&T"* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | GVJ vëren , nga shqyrtimi i dokumentacionit, se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.<br><br>Bazuar në DVV dhe informacionin gjatë vizitës në Fakultetin e Artit Skenik verehet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Analiza e procesit mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik. Për të bërë këtë analizë, Departamenti i A&T mbështetet në sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, në anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritë mësimore. Stafi akademik i angazhuar në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim, në përfundim te procesit mësimor shprehet për problematikat që ka hasur dhe mund të propozojë ndryshime në elemente të programit të lëndës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të saj.Nga ana tjetër UART ka zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. Janë pajisur me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë.<br><br>UART përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore.Në lidhje me mësimdhënien, pedagogët respektojnë rregullat e institucionit, mbi mënyrën e |

| | |
|---|---|
| | zhvillimit të orës së mësimit, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen atyre, etj.<br><br>*Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit teperfomancës vjetore Strukturat kryesore per përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konstatojmë se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmblidhen në një raport periodik. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe e vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. Strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë njësitë bazë.<br>Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik me qëllim përftimin e eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. Organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike me studentë e pedagogë, bashkëveprimi me departamente të tjera janë një nga format e veçanta dhe inovative të mësimdhënies në A&T.<br>Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë me formimin artistik të pedagogëve, të cilat janë pasqyruar në artikuj e botime të tjera shkencore, ëorkshope dhe konferenca artistike kërkimore-shkencore. Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trajnimi i stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit. Departamenti A&T/FAS ka zhvilluar disa takime në parim me Fakultetin e Shkencave Sociale për të mundësuar trajnime, seminare dhe konferenca me qëllim ngritjen e nivelit mësimdhënës të pedagogëve të rinj nga pikëpamja psikopedagogiike.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART"*<br>*Evidenca 3.2 "Aktivitete të Erasmus/Erasmus+ "*<br>*Evidenca 3.8 "Pjesëmarrja e as/lektorëve FAS në trajnime psikopedagogiike "*<br>*Evidenca 3.5 "Dosja e studentëv eaktualë te doktoraturës nga stafi A&T"*<br>*Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësoret e studentëvenë FAS"* |
| **Konkluzion** | *UART bazuar në dokumente e rregullatore dhe përvojës së gjatë në formimin e artistëve, ka ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë. Çdo lëndë mësimore ndërthur leksionet,* |

| | |
|---|---|
| | *seminare, detyrat e kursit,vlerësim të vazhdueshëm dhe vlerësimin përfundimtar. Pedagogët përdorin metodat e mësimdhënies me në qendër studentin .*<br><br>*Stafi akademik ka kompetencën e duhur mësimdhënëse dhe praktike aktoriale dhe përputhje në lëndët që mbulojnë me fushat e tyre të ekspertizës.*<br><br>*Personeli nxitet dhe mbështetet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Gjithashtu në takimin me studentët e programit Bachelor GVJ konstaton se ata shprehen pozitivisht për njohuritë që kanë fituar, për aftësimin e tyre, për përfshirjen e tyre në jetën e institucionit, për mbështetjen që kanë gjetur në institucion dhe nga pedagogët si dhe për trajtimin me respekt nga stafi akademik. Ky vlerësim kryhet edhe nëpërmjet pyetësorëve të vetëvlerësimit nga stafi akademik dhe vlerësimit përmes pyetësorëve të plotësuara nga studentët.*<br><br>*Cilësia e mësimdhënies dhe performanca e stafit akademik është objekt i analizës periodike nga departamenti .* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen ngastudentët. | GVJ konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e miratuara për mirëfunksionimin e programeve si Rregullorja e Departamentit A&T, Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit, Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim, Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim.<br>Në vlerësimin përfundimtar të studentit merren në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, laboratorët, kontrollet e pjesshme, frekuentimi, etj. Shkalla e rëndësisë së secilit element në vlerësimin përfundimtar është e lidhur me peshën që zënë ato në ndarjen e krediteve të përcaktuar në planin mësimor dhe në programin e lëndës.<br>Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë mësimit të çdo semestri.Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së lëndës. Ai përcaktohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me Përgjegjësin e |

| | |
|---|---|
| | Njësisë Bazë, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga Dekani.<br>Format organizimit të provimit në FAS janë: Provimi i lëndëve speciale; Provimi me shkrim në klasë brenda një afati kohor të caktuar; Provim me shkrim e me gojë,ku provimi me shkrim është parakusht për të hyrë me gojë; Provimi në grup në realizimin e veprave artistike sipas programit të miratuar.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë te studimit"*<br>*Evidenca I. 18 "Rregullorja e Programit te Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit tëStudimit Bachelor në Aktrimi* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari I lëndës/modulit. | Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se departamenti A&T/FAS informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve.<br><br>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i programit të studimit.<br><br>I gjithë informacioni mbi përmbajtjen e programit të studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen zyrtare ëëë.uart.edu.al . Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër njihen me të gjithë syllabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve modalitetet e vlerësimit të saj, literatura e rekomanduar. Gjithshtu gjithë syllabuset e programeve gjenden të aksesueshme prej studentëve pranë Departamentit A&T. Shpjegime mbi ndjekjen e programit, lendët, detyrimet akademike dhe ato administrative, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin, jepen edhe në Javën e Orientimit prej stafit akademik të Departamentit A&T.<br>Studentët vlerësuan faktin se janë të njohur me të gjitha format e mësimit dhe vlerësimit dhe i kanë të qarta objektivat .<br>Vlerësimi bazohet në elemenë të tillë si : pjesa artistike, pjesa teorike, pjesa ushtrimore, detyrat, projektet artistike, kontrollet e pjesshme; frekuentimi, etj'. Shkalla e rëndësisë së secilit element në lerësimin përfundimtar është e lidhur me peshën që zënë ato në ndarjen e krediteve të lëndës sipas veprimtarive formuese të saj, të përcaktuar në planin mësimor dhe në programin e lëndës.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë tëstudimit"*<br>*Evidenca I. 18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor nëAktrim "*<br>*Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi I njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Duke iu referuar DVV , GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Neni 30 i Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në Aktrim përcakton një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Format kryesore të procesit mësimor janë: Format e mësimit teorik e praktik: mësimet artistike, profesionale individuale dhe kolektive, leksionet, seminaret, ushtrimet, praktikat profesionale, projektet artistike individuale dhe kolektive, konsultimet, etj.<br>Format e kontrollit të dijeve: bashkëbisedimet, kontrollet teknike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike, etj.<br>Kontrolli i dijes bëhet nëpërmjet: Provimit me shkrim; Provimit me gojë; Vlerësimit të detyrave dhe të projekteve; Kombinimi i tre formave të sipërme: me shkrim, me gojë dhe me projekt; Provimi i formimit artistik (lëndë të formimit special) konsiston në realizimin artistik profesional të një fragmenti apo shfaqjeje të plotë; Provimi në grup dhe individual;<br><br>*Evidenca 1.17 Rregullorja e Departamentit A&T*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë të studimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit te Studimit A&T* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësimet bëhen pjesë e analizës në njësinë bazë dhe përdoren për përmirësimin në vazhdim të shërbimeve të ofruara nga njësia bazë dhe ajo kryesore.<br><br>Analiza e procesit mësimor bëhet në përfundim të vitit akademik duke marrë parasysh sugjerimet dhe komentet e stafit mësimdhënës, të dhënat nga anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna që gjenerohen nga sekretaritë mësimore. A&T analizon të gjitha elementet e realizimit të procesit mësimor,si mësimdhënien, realizimin e formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe provimit përfundimtar të lëndëve, praktikat profesionale, realizim punimeve të diplomave, dhe bën propozimet përkatëse për ndryshime, nëse e vlerëson të arsyeshme. Përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies i shërben edhe mbikëqyrja e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe gjithë dokumentacionit të programeve të studimit. Mbështetja nga personeli administrativ për procesin mësimor nëpërmjet elementëve të tillë si regjistrimi video i provimeve dhe projekteve teëkursit të studentëve; realizimet e dekoreve apo efekteve praktike; realizimin e elementeve të ndryshme të teknikës skenike; sigurimin e kostumeve, rekuizitave |

| | |
|---|---|
| | dhe elementeve të tjera skenike; mirëmbajtja e bazës laboratorike të videotekës së FAS; ndihmesë në zhvillimin e praktikave të diplomave ndihmojnë në realizimin cilësor të këtij programi.<br><br>*Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të perfomancës vjetore "*<br>*Evidenca 3.7 "Të dhëna ngapyetësorët e studentëvenë FAS"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Në lidhje me mësimdhënien UART mbështet dhe nxit përdorimin e metodave aktive , që nxisin dhe zhvillojnë talentin e studentit. Duke qenë se çdo lëndë ka specifikat e saj, pedagogu zgjedh forma të ndryshme të mësimdhënies, të aktivizimit të studentëve, duke kombinuar aspektin teorik më atë praktik.<br>UART mbështet personelin akademik në aspektin didaktik dhe përdorimit të teknologjisë. Kjo realizohet përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe programeve ndërkombëtare si Erasmus dhe Erasmus+. Departamenti mbështet vizitat dhe shkëmbimet e stafit akademik me institucione ndërkombëtare, duke përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete artistike dhe shkencore, që kontribuojnë në rritjen e kualifikimeve dhe adoptimin e praktikave pedagogjike më efektive. Kjo qasje ndihmon stafin të lidhë mësimdhënien me zhvillimet më të fundit ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut te punës.<br>Në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe specifikat e tij, mundësohet përdorimi i metodave të përshtatshme të zhvillimit të mësimit në lëndë. Ky program studimi zhvillohet me grupe të vogla studentësh ose individual, format unik, që mundëson studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese dhe analitike në një mjedis që promovon të menduarit e pavarur në një ambient mbështetës dhe nxitës, bashkëpunues midis studentëve dhe pedagogëve.<br>Në takimin me studentë dhe pedagogë të këtij programi GVJ u informua për zhvillimin e mësimit në një ambient mbështetës dhe bashkëpunimi. Të dy grupet vlerësuan se gjatë punës krijohet një marrëdhënje respekti, plotësim të kërkesave dhe njohje më e mirë, ku studentët dhe pedagogët punojnë si bashkë aktorë.<br>GVJ thekson se motoja ''Mësim me studentët ne qendër të procesit mësimor"" ka një kuptim real në këtë program studimi ku pedagogët dhe studentët punojnë të zhvillojnë aftësi të pavarura dhe përgjegjshmëri të nevojshme per krijimin artistik dhe profesional dhe për përgatitjen e aktorëve për tregun e punës.<br><br>*Evidenca 3.4 Dosja e titujve akademikë dhe gradave shkencor të stafit*<br>*Evidenca 3.8 Pjesëmarrja e as/lektorëve FAS në trajnime pedagogjike"* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzion** | *UART ka hartuar qartë dhe në detaje rregulloret institucionale për të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve. Rrregulloret janë hartuar në përputhje me specifikën e këtij Universiteti dhe të Programit Bachelor në Aktrim.*<br>*Informimi dhe njohja e studentëve më format e zhvillimit të mësimit dhe vlerësimit bëhen me forma të ndryshme dhe të lehta për t'u aksesuar nga studentët.*<br>*Format e ndryshme dhe metodat e mësimit, me në qëndër studentin, krijojnë një ambient mbështetës, nxitës dhe respekt reciprok. Institucioni mbështt zhvillimin profesional të pëdagogëve. GVJ konstaton se si studentët dhe pedagogët vlerësojnë ambientin e ngrohtë dhe të punës që krijohet.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari I lëndës/modulit. | Mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Të gjithë këta elementë i bëhen të ditur studentëve prej pedagogëve të lëndëve dhe në syllabuset e përditësuara të lëndëve, në orën e parë të mësimit.<br>Vlerësimi i studentit kryhet në mënyrë të vazhdueshme e shtrirë gjatë gjithë semestrit ose vitit. Në programin e lëndës (syllabus), është percaktuar qartë edhe mënyra e vlerësimit. Vlerësimi i studentëve përfshin : Pjesëmarrje aktive në orën e mësimit: 10%;<br>Provimi i ndërmjetëm: 20%;<br>Detyrat e kursit: 20%<br>Provimi përfundimtar: 50%<br>Provimet në FAS zhvillohen brenda periudhave të përcaktuaranë strukturën mësimore të vitit akademik dhe zhvillohen në tri sezone: Sezoni i provimeve të dimrit; Sezoni i provimeve të verës; Sezoni i provimeve të vjeshtës. Nëse studenti nuk ka shlyer detyrimet e lëndës në kohën normale të zhvillimit të saj, ai duhet t'i shlyejë ato para fillimit të sezonit të provimeve, në periudhën e shpallur nga Dekani. |

| | |
|---|---|
| | GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Në takimin me studentët na u konfirmua që përfshirja e këtyre formave të shumëllojshme të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë e tyre.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë të studimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.1 "PlaniMësimor Bachelor nëAktrimi"*<br>*Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Për vetë natyrën specifike që kanë programet e studimit të cilat ofrohen në Universitetin e Arteve dhe mënyrës së organizimit të testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, grupeve të vogla , në FAS/UART zbatohet sistemi i provime të cilat zhvillohen kryesisht në auditor dhe eshtë e pamundur të aplikohen sistemet e kontrollit elektronik. Provimet e lëndëve profesionale janë lëndë provimet e të cilave zhvillohen në shfaqje. Provimet e lëndëve me karakter teorik janë zhvilluar kryesisht të sekretuara, por edhe me gojë duke alternuar të dy metodat. Shfaqjet janë publike, kështu është një transparencë e kënaqshme.<br>Kjo formë vlerësohet edhe nga studentë, siç u evidentua gjatë takimit që GVJ organizoi me ta. Gjatë periudhës së pandemisë u përdor Sistemi Teams.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit te Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 3.9 "Manualii Programit Online Teams "*<br>*Evidenca 3.10 "Manuali i mësimdhënies* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Vlerësimi përfundimtar i njohurive, kompetencave dhe aftësive të fituara nga studentët, si në përmbajtje teorike, ashtu edhe në praktikën profesionale dhe punimin e diplomës, kryhet nga titullari i lëndës/modulit përkatës ose nga një pedagog tjetër i caktuar, sipas parashikimeve të përcaktuara në planin mësimor.<br>Për realizimin e praktikës profesionale dhe mbrojtjen e diplomës, ngrihen komisione të veçanta të cilat funksionojnë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në Aktrim, të miratuar nga organet përkatëse të institucionit. Këto komisione garantojnë transparencë, objektivitet dhe standarde akademike në procesin e vlerësimit final.<br>Provimi përfundimtar zë 50% të totalit të përgjithshëm të vlerësimit të studentit. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | Në përfundim të programit të studimit, për realizimin e detyrimeve përmbyllëse studentët japin provimin e diplomës që përfshin Mbrojtjen artistike të diplomës (8 kredite) dhe Paraqitje e punimit të diplomës me tekst ( 2 kredite) .<br>Për format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë dhe provimet bëhen të sekretuara. Tezat e provimit për lëndët teorike, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/ët i/e lëndës. Ato miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit A&T dhe nënshkruhen prej tij.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të parë të studimit*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim*<br>*Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor nëAktrim*<br>*Evidenca 3.11 "Pasqyrat e Ngarkesave Aktrim* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Formimi teorik dhe praktik i studentëve në Programin e Aktrimit vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik, në bazë të elementëve të parashikuar në planin mësimor, si dhe përmes testimeve përfundimtare vjetore, provimeve të praktikës profesionale dhe mbrojtjes së diplomës apo provimit të formimit. Duke marrë parasysh karakterin specifik të lëndëve artistike, në Fakultetin e Arteve të Scenës, studentëve u ofrohet këshillim i drejtpërdrejtë dhe feedback individual në përfundim të çdo ore mësimore, me synimin për të nxitur përmirësimin profesional të vazhdueshëm dhe rritjen e cilësisë së performancës artistike.<br>Punë individule dhe me grupe të vogla lehtëson dhënien e feedbackut dhe reagimin e studentëve. Kjo formë ndikon ndikon drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e orës së mësimit apo realizimit të programit të lëndës.<br>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua për vlerësimin e studentëve për këtë mënyrë kontrolli e dhënie feedback-u.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit Aktrim*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë të studimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit te Studimit Aktrim* |
| **Kriteri 5.**Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Institucioni ka parashikuar në rregulla që shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra të parashkruara në rregulloret e miratuara. Vetë natyra specifike e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim nuk ofron mundësi plagjiature në provim, pasi studenti dhe pedagogu punojnë ngushtësisht dhe për të nxënit përgjatë të gjithë vitit akademik. Në kohën e kryerjes së provimeve, në mjedisin ku kryhet provimi janë të pranishëm grupi i studentëve që kryejnë provimin dhe anëtarët e komisionit të provimit. Përgjegjesi i Departamenti A&T apo persona tëtjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani i FAS ose Rektori lejohen të |

| | |
|---|---|
| | hyjnë në mjediset ku zhvillohet provimi për të kryer kontroll. Në raste specifike, kryesisht provimet e lëndëve speciale artistike (shfaqiet) Dekanati vendos zhvillimin e provimit në mjedise të hapura për publikun.<br>Nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve/laptopëve/tabletave apo pajisjeve të tjera elektronike dhe janë parashikuar masa disiplinore nëse shkelen rregullat e përcaktuara.<br>Gjithashtu verifikimi i cilësisë së punimeve shkencore është realizuar përmes platformës anti-plagjiaturë të vënë në dispozicion nga RASH dhe të administruar nga Sektori i TI sipas udhëzimeve të Këshillit të Etikës së institucionit.<br><br>Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T<br>Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tël-rë të studimit<br>Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të StudimitAktr Q:<br>Evidenca 3.12 "Rregullorja e Këshillit tëEtikës" |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata janë të vetëdijshëm për rezultatet e tyre dhe se vlerësimi është bazuar në atë që meritojnë. Kjo është edhe për faktin se para marrjes së vlerësimit përfundimtar ata njihen nga pedagogët me vlerësimin përfundimtar para vendosjes së notës.<br>Rezultatet e kontrollit të dijeve jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.<br>Rezultatet përfundimtare hidhen edhe në Sistemin elektronik dhe janë të shënuar në rregjistrin e Sekretarisë mësimore. Studenti mund të ndjekë dhe të ketë të gjitha vlerësimet sipas komponentëve përkatës në sistemin PITAGORA. Sistemi përdoret nga pedagogët për pasqyrimin e rezultateve dhe përpilimin e procesverbaleve, përdoret nga studentët per informimin e tyre lidhur me aktivitetin akademik në Universitet.<br><br>*Evidencal. 17 "Rregullorja e Departamentit Aktrim "*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-re tëstudimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të StudimitAktrim*<br>*Evidenca 3.13 "Screenshot-e nga sistemi Pitagora"* |
| **Kriteri 7.**Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Duke iu referuar dokumentave në DVV vihet re se studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se tri deri në pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar |

| | |
|---|---|
| | interpretimin/aktrimnë/përgjigjet e dokumentuar apo regiistrimet (kur ka) e studentit me shfaqjen/tezën e zgjidhur.<br>Në rastet e kontestimit të rezultatit, në komision duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i Departamentit A&T, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Kontestimi i rezultatit nga ana e studentit bëhet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë tëstudimit*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit A&T* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në rregulloren e Departamentit dhe të Programit përcaktohet se studenti ka të drejtë te ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamerituar për përgjigjen që ka dhënë ose për performancën artistike që ka realizuar. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim brenda një afati prej 24 orësh nga shpallja e rezultatit në Dekanatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të therrasë për sqarime komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë brenda 3 (tre) ditëve. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit dhe vendos që studenti të japë përsëri provimin, me të njëjtin komision ose me një komision të ri dhe nën monitorimin e një përfaqësuesi të caktuar nga Dekani.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë tëstudimit*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit A&T* |
| **Konkluzion** | *Departamenti A&T ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve. Zbatohet një praktikë e konsoliduar për një vlerësim bazuar në meritë dhe transparent.*<br><br>*Departamenti ka rregullore të përcaktuara qartë për ndjekjen e ecurisë së vlerësimëve, shpallja e tyre bëhet në kohë reale dhe është transparente.*<br><br>*GVJ shënon se bazuar punës në grupe të vogla dhe individuale dvleresimi dhe dhenja e feebbackut është i vazhdueshëm dhe efektiv.*<br><br>*Nuk u shënua ndonjë praktikë e ankimit të vlerësimit përfundimtar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioningrestrukturatëposaçmenënivelinstitucional, tëcilatpromovojnërritjen e vetëdijespërpërmirësimin e cilësisësëmësimdhëniesdhemësimnxëniesnëprogramet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri1.** Programi I studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Aktrim synon të ofrojë formim të plotë akademik dhe profesional në fushën e aktrimit. Ky program është konceptuar për të zhvilluar njohuri themelore artistike dhe shkencore, duke ndërtuar kapacitete teorike e praktike tek studentët, në përputhje me kërkesat bashkëkohore të tregut dhe të arsimit të lartë. Gjithashtu, programi nxit zhvillimin e aftësive për kërkime të pavarura artistike dhe shkencore, si dhe përgatit studentët për përfshirje aktive në jetën artistike dhe kulturore, apo për ndjekjen e studimeve të mëtejshme në ciklet pasardhëse.<br>Ky program synon: Rrënjosje të njohurive bazë, koncepteve, aftësive teorike dhe praktike mbi interpretimin skenik; përgatitjen e studentëve për formimin e kompetencave dhe aftësive që iu korrespondojnë niveleve të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit në fushën e aktrimit;trajnimin për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të krijimit dhe kërkimit në aspekte që kanë të bëjnë me aktrimin, dramaturgjinë, teatrologjinë, kritikën teatrore, stilet edhe shkolla të ndryshme të krijimit të interpretimit skenik, etj. ; arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare; krijimin e një baze solide që shkon përtej njohurive standarde, duke zhvilluar kompetencatë larta akademike dhe profesionale; një formim teorik e praktik rreth fushës së artit dhe të mësimdhënies ; zhvillimin e aftësive të duhura për organizimin praktik të veprimtarive artistike kulturore.<br><br>Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"<br>Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-re të studimit"<br>Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim<br>Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim |
| **Kriteri 2.** Programi I studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, | Përfshirja në planin mësimor e lëndëve si Aftësim Informacioni, Gjuhë e huaj, Psikologji si dhe përfshirja e njohurive informatike në lëndë të ndryshme (Lënda Aktrim Televizive për shembull) dhe lidhja ndërlëndore mundëson formimin e një prefesionisti jo vetëm të aftë si artist, por edhe më aftësi humane dhe komunikuese. Zhvillimi i gjithë programit dhe objektivat e tij bazohen në |

| | |
|---|---|
| sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | ndërveprimin e studentëve me njëri-tjetrin, pedagogun dhe spektatorin.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-re të studimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Rezultate e të nxënit dhe kompetencat që duhet të fitojë një studentë janë të parashikuara në program dhe në syllabuset e lëndëve. Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë kryesore dhe bazë konstatojmë se kompetencat, aftësimi teorik dhe praktik i studentëve kontrollohen përmes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuar në program dhe vlerësimit përfundimtar në provimet e fund-viti, të praktikës profesionale si dhe në mbrojtjen e diplomave apo temave teorike. Pedagogët bëjnë vlerësime sistematike të punës së studentëve dhe japin feedback në kohë reale.<br>Në FAS, për vetë natyrën specifike të organizimit të mësimit ne lëndët speciale, mbështetur në VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 studentët këshillohen në përfundim të çdo ore mësimi me qëllim përmirësimin e punës dhe arritjeve në fushën e interpretimit skenik. Kjo është formë shumë efektive në formimin e artistëve dhe një praktikë e konsoliduar në departament. Edhe gjatë takimit me studentë u konfirmua kjo formë e organizimit të feedback-ut.<br>Në përfundim të semestrit, çdo pedagog kryen analizën e punës së lëndës dhe klasës së tij për të evidentuar arritjet dhe për të përcaktuar detyrat për përmirësimin e punës për semestrin pasardhës. Më pas kjo analizë bëhet në rang departamenti dhe më tej në rang fakulteti.<br><br>*Evidenca 1.4 "VKM Nr. 145, date 10.03.2021, "Për dhënien e Statusit te vecantë UART" Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë të studimit"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit tëperfomancës vjetore "* |
| **Kriteri 4.**Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në | Duke iu referuar DVV dhe takimeve me stafin dhe drejtuesit e njësisë GVJ konstaton se përmbajtja e programit, format e mësimdhënjes dhe të vlerësimit si dhe mënyra e organizimit të grupeve dhe dhe metodat e mësimdhënjes formojnë dhe zhvillojnë tek studentët kompetenca të përgjithshme e të veçanta dhe të transferueshme në fushën e artit dhe edukimit artistik.<br>Praktika profesionale ju mundëson studentëve zbatimin e këtyre kompetencave në veprimtaritë respektive në institucionet arsimore, kulturore artistike sipas marrëveshjeve të arritura me to. |

| | |
|---|---|
| interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Studentët e këtij programi bashkëveprojnë me njëri-tjetrin brenda programit, studentët e programeve të tjera, brenda institucionit apo dhe në institucione të tjera artistike kulturore.<br>Stafi akademik i Fakultetit të Arteve të Scenës siguron një mjedis të përshtatshëm pedagogjik që nxit zhvillimin e ideve krijuese dhe kërkimeve artistike-shkencore nga studentët. Pedagogët inkurajojnë studentët të formulojnë dhe të zhvillojnë projekte individuale apo në grup, në përputhje me objektivat e programit dhe profilin profesional të tyre, duke i orientuar drejt zbatimit konkret në kontekstin e praktikës artistike.<br>FAS/UART mbështet iniciativat inovative të studentëve në art, duke ofruar informacion të përditësuar për zhvillimet bashkëkohore në fushën e artit dhe kulturës. Kjo realizohet përmes angazhimit aktiv të studentëve në interpretime skenike, veprimtari artistike, si dhe nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimeve ndërinstitucionale dhe mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit Aktrim dhe Teori*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit tëI-rë të studimit*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të StudimitAktrim*<br>*Evidenca 3.2 "Aktivitete te Erasmus/Erasmus+ "* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë structures së programit të studimit. | Personeli akademik i angazhuar në FAS përbëhet nga figura të njohura dhe të vlerësuara në fushën e artit skenik. Ky trup pedagogjik organizon në mënyrë të vazhdueshme veprimtari artistike jashtë strukturës së programit të studimit, të tilla si shfaqje teatrore, mbrëmje poetike, diskutime tematike dhe shkëmbime profesionale, në bashkëpunim me trupa teatrore dhe institucione artistike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këto veprimtari përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të jetës akademike dhe artistike në FAS, duke pasuruar përvojën formuese të studentëve dhe duke ofruar një platformë për promovimin e zhvillimeve bashkëkohore në fushën e aktrimit dhe arteve skenike. Përmes kësaj qasjeje, Fakulteti synon të forcojë lidhjen midis arsimit, kërkimit artistik dhe praktikës profesionale, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe kulturore.<br><br>*Evidenca 3.3 "Aktivitete të ëorkshopeve/masterklaseve 2022-2024*<br>*Evidenca 3.6 "Lista e realizimeve artistike të stafit Departamenti A&T 2022* |
| **Konkluzion** | *Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të* |

| | |
|---|---|
| | *bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës. Ky program është plotësisht në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar. Lëndët e përfshira në të krijojnë të gjitha kushtet për arritjen e objektivave që synon programi i studimit, për krijimin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme për tregun e punës dhe për vazhdim të studimeve në Ciklin e dytë.*<br><br>*Në përfundim të lëndës stafi akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në syllabusin e lëndës. Konkluzionet e nxjerra nga analizat e kryera në grupet lëndore dhe në departament reflektohen në përmisimin e programit të studimit.*<br><br>*Në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar nga personeli akademik janë realizuar shfaqje , mbrëmje poetike, biseda, shkëmbime, në bashkëpunim me trupa apo teatro vendas apo të huaj duke sjellë një larmi programesh, formash, gjinish të ndryshme të cilat shërbejnë për studentët si forma më efikase për të prezantuar zhvillimet dhe arritjetmë të rejat në fushën e Aktrimit dhe të artit në përgjithësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin I përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notes mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diploma dhe e bën atë publike. | UART/FAS dhe si rrjedhojë edhe departamenti A&T gëzojnë status të veçantë për shkak edhe të mënyrës totalisht të ndryshme të kërkesave të programit dhe mënyrës së zhvillimit të lëndëve profesionale në auditor dhe jashtë tij. Referuar këtij statusi të veçantë Departamenti ka parcaktuar me saktësi mënyrën e zhvillimit të Diplomës. Të gjithë studentët duhet të mbrojnë diplomën sipas përcaktimeve në Rregullorja e Departamentit A&T. Në nenet 33 -37 parashtrohen me detaje procedurat për modalitetin e diplomimit, punimin dhe përgatitjen e diplomës. Organizimin e mbrojtjes së diplomës dhe vlerësimin e punimit të diplomës. Në këtë program studimi Diploma përbëhet nga Tema Teorike dhe Projekti artistik.<br><br>*Evidenca 1.4 "VKMNr. 145, date 10.03.2021, "Për hen/ëjg:æstatusit veqante UART") Evidenca 1.5 "Statuti i UART"*<br><br>*Evidenca I. 15 "Rregullorja e ciklit tël-rë të studimit "* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 1,16 "Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS"*<br>*Evidenca 1.17 " Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca I. 18 Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Strukturat përgjegjëse në UART dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale në lidhje me detyrimet përmbyllëse.<br>Informimi dhe këshillimi realizohet nëpërmjet strukturave përkatëse, informimit online nëpërmjet faqes zyrtare të UART. Gjithashtu pedagogët e lendëve informojnë studentët gjatë kontakteve të herëpashershme dhe të vazhdueshme me ta duke i udhëzuar lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe kryesisht duke i udhëzuar edhe mbi provimin e diplomimit të tyre. Në funksion të udhëheqjes së temave të studentëve, pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat e takimit me studentët. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e pedagogut udhëheqës si dhe pa përmbushur të giitha detyrimet e tjera të programit të studimit.<br>Referuar Rregullores së programit të studimit, në fillimi të vitit të fundit akademik, studentëve u jepet informacioni i domosdoshëm mbi temën e diplomës si dhe paraprakisht orientohen drejt fushave dhe temave.<br><br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T"*<br>*Evidenca I. 18 "Rregullorja e Programit të Studimit A&T* |
| **Kriteri 3.**Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Rregullorja e Fakultetit, Departamenti dhe Programit përcakton modalitetin e detyrimeve përmbyllëse, me Diplomë dhe paraqitja e punimit të diplomës në FAS bëhet sipas normave të përcaktuara nga "Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e FAS" dhe ndjek procedurat e miratuara nga Dekani përpara se ajo të mbrohet në komisionin përkatës.<br>Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese në formën e një projekti artistik dhe Temë Teorike.<br>Punimi i diplomës përmban një sërë detyrash e kërkesash, mënyra e shtrimit te të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete projektuese artistike, të tregojë aftësitë e tij profesionale artistike dhe kompetencën për të kryer realizime artistike në fushën përkatëse.<br>Gjatë takimeve me stafin akademik u theksua se kjo mënyrë e organizimit të detyrimit përmbyllës është e zakonshme në shkollat |

| | |
|---|---|
| | e artit dhe provon e vlerëson njohuritë dhe kompetencat e studentëve në mënyrë objektive dhe transparente.<br><br>*Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS*<br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departamentit A&T*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi i temës së diplomës caktohet nga Departamenti pas dakordësosisë midis pedagogut dhe studentit. Udhëheqës janë pedagogë të lëndëve speciale.Pedagogu dhe udhëheqësi përcaktojnë planin e punës së përgatitjes së diplomës. Kjo punë zhvillohet në vitin e tretë të studimeve dhe më e përqëndruar në semestrin e dytë të viti të tretë.<br>Përgatitja e diplomës konsiston në takime sipas orarit të mësimit të përcaktuar që në fillim të vitit akademik, janë takime individuale, pasi problematikat lidhur me realizimin e mbrojtjes së diplomës varen nga shkalla e talentit, puna individuale e studentit, serioziteti dhe përkushtimi në punë.<br>Nëse studenti, për arsye të ndryshme objektive apo subjektive nuk arrin të mbrojë diplomën në sezonin e caktuar, ai ka të drejtë të mbrojë diplomën në tre sezonet pasardhëse. Vendimin për paraqitjen apo jo te punës së diplomës përpara komisionit e merr pedagogu përgjegjës duke vlerësuar elementet artistike, teknike por edhe pedagogjike.<br>Në rast të pretendimeve nga ana e studentit ndiqet rruga e ankimimit në instancat dhe kohët e përcaktuara nga rregulloret e FAS/Departamenti A&T.<br><br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit"*<br>*Evidenca 1.17 "Rregullorja e Departanlentit A&T"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 2.1 "Plani Mësimor Bachelor në Aktrim"* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | FAS/Departamenti A&T i asiston dhe i mbështet studentët per kryerjen e projekteve artistike duke respektuar maksimalisht profilin e tyre individual. Projektet artistike mbështeten nga Departamenti A&T kryesisht në drejtim të mbështetjes infrastrukturore. Përveç strukturave të brendshme të UART në funksion të programeve të mësimit FAS/Departamenti A&T përfshin në procesin e realizimit të punimeve të studentëve tanë edhe partnerë lokalë apo kombëtarë duke siguruar mjediset e nevojshme (sallat, dekoret, teknikën audio dhe ndriçimin) dhe gjithë mbështetjen logjistike e njerëzore, duke siguruar kështu kushte optimale pune për realizime cilësore të projekteve artistike.<br><br>*Evidenca 3.16 "Korrespondenca me partnerët në shërbim të shfaqjeve të studentëvetëDepartamentit A&T"* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve mësimore te fakulteteve është edhe zyra e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit.<br>Referuar DVV, FAS ka hartuar rregulla për procedurat e diplomimit të studentëve. Në përfundim të procesit të provimit të diplomës studentët vlerësohen me notë nga antarët e komisionit të ngritur për këtë qëllim. Pas mbarimit të procesit të mbrojtjes së diplomës Kryetari i komisionit mbledh anëtarët e komisionit të cilët vlerësojnë me pikë dhe e nënshkruajnë atë.<br>Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë secili anëtar i komisionit, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve te komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet proces verbalit të mbrojtjes së diplomave, ku regjistrohet nota përfundimtare. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative, ose nuk paraqitet ai mund të mbrojë punimin e diplomës, në tre sezonet pasardhëse.<br><br>*Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim* |
| **Kriteri 7.**Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës në përfundim të studimeve.Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror te diplomave dhe certifikatave Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".<br><br>*Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim*<br>*Evidenca 3.14 "Udhëzimin nr. 25, date 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave '* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatojmë se dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, vihet re një organizim i mirë i arkivës dhe i materialeve për çdo student, lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë.<br><br>Informacioni i veprimtarisë akademike në UART përpunohet në kopje fizike dhe në formë elektronike. Veprimtaria akademike për FAS ruhet në të dyja llojet e formatit sipas njësive të ngarkuara për këtë proces nga fillimi deri në përfundimin e tij.<br><br>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara |

| | |
|---|---|
| | apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART"*<br>*Evidenca 3.15 "Pasqyrë per përdorimin e pajisjeve dhe shërbimeve të teknologjisë* |
| **Konkluzion** | *FAS/ A&T , si njësi të UART, ka përcaktuar qartë procedurat e përfundimit të studimeve, dhe mbrojtjes së diplomës.*<br><br>*FAS pajis studentët me diplomë sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj.*<br><br>*Studentët ndihmohen nga stafi akademik dhe stafi ndihmës akademik me informacionet e nevojshme dhe udhëzime ose materiale të tjera. Detyrimi përmbyllës përfshin shkrimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës sipas rregullores së miratuar më parë.*<br><br>*Studenti ndihmohet nga udhëheqësi i punimit të diplomës i cili punon individualisht me studentin për përgatijen e diplomës dhe të projektit artistik.*<br><br>*Procedura e mbrojtjes së diplomës përcaktohet nga rregullorja përkatëse. Në përfundim të programit të studimit studenti pajiset me diplomën përkatëse. Elementet përbërëse, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.*<br><br>*Sekretaria mësimore e FAS ruan dokumentacionin e studentit dhe lëshon dokumenta sipas kërkesës së studentëve dhe sipas rregullave në fuqi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1** |
|---|

| **Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dheveçorinë e moduleve të tij. | Referuar RVB dhe materialeve në DVV si dhe takimeve me stafin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në Programin e Studimit Bachelor në Aktrim, GVJ konstaton se personeli i angazhuar i përmbahet kërkesave të parashikuara në Ligjin dhe VKM përkatëse.<br>Personeli akademik me kohë të plotë përmbush kërkesat për kualifikimin shkencor dhe përvojë artistike, siç është dokumentuar në CV-të e tyre. Për vetë natyrën e veçantë të programit të studimit, Departamenti i A&T bazohet në eksperiencën artistike-shkencore të stafit akademik në funksion të lëndëve për të cilat materializohet angazhimi. Specifikisht për lëndë speciale, janë angazhuar pedagogë me eksperiencë të gjatë, duke anagazhuar në interpretime dhe studentët e tyre në projekte artistike të ndryshme.<br>(Referuar dok.34 Evidenca 1.27. Aneks, Tabelat e Stafit Akademik) FAS rezulton se personeli akademik paraqitet si në vijim për degën Bsc në Aktrim :<br>Personeli akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2024-2025 15 staf akademik me kohë të plotë; personeli akademik me kohë të pjesshme 10; total i personelit akademik 25.<br><br>***Të dhënat e mëposhtme për 3 vite akademike për programin e studimit Bachelor në "Aktrim":*** |

| **Tituj/ grada** | **2022 – 2023** | | **2023 – 2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** |
| Prof. | 3 | - | 2 | 2 | 1 | 1 |
| Prof. Asoc. | 5 | - | 5 | - | 5 | - |
| Dr./PhD. | 4 | 4 | 4 | 4 | 4 | 2 |
| Lektor | - | - | - | - | - | - |
| As.Lektor | 6 | 4 | 5 | 5 | 5 | 7 |
| **Totali** | **18** | **8** | **16** | **11** | **15** | **10** |

Sipas normativave ligjore në fuqi për arsimin e lartë, përbërja e stafit akademik në një program studimi duhet të jetë në përputhje me

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

<table>
<tr><td></td><td>përqindjet e përcaktuara: të paktën 70% e stafit duhet të jenë me status të Personelit Akademik me Efektiv (PAE), dhe jo më shumë se 30% të jetë Personel Akademik me kontrate (PAK).<br><br>
<table>
<tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>3215</td><td>2705</td><td>510</td><td>84,1% / 15,8 %</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>3055</td><td>2305</td><td>750</td><td>75,4% / 24,5 %</td></tr>
<tr><td>2024-2025</td><td>2935</td><td>2305</td><td>630</td><td>78,5%/ 21,4 %</td></tr>
</table>
<br>Evidenca 1.27 "Tabelat e Stafit Akademik FAS"<br>Evidenca 1.1. "Ligji I Arsimit të Lartë 80/2015"<br>Evidenca 4.5 "Lista e stafit ndihmës akademik A&T"</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td><td>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për më tepër, struktura e programit të studimit është e përcaktuar me qartësi dhe transparencë, duke grupuar lëndët dhe modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe duke caktuar ngarkesën përkatëse në kredite.<br>Planifikimi i programit të studimit përfshin një plan mësimor me informacion të detajuar lidhur me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve dhe moduleve, si dhe orët e caktuara për mësim në auditor dhe jashtë tij.<br>Referuar takimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore mbulohet në pjesën më të madhe nga stafi akademik me kohë të plotë, por për lëndë specifike departamenti kërkon specialistë përkatës duke hapur thirrje për personel akademik me kohë të pjesshme.<br><br>
<table>
<tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>3215</td><td>2705</td><td>510</td><td>84,1% / 15,8 %</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>3055</td><td>2305</td><td>750</td><td>75,4% / 24,5 %</td></tr>
<tr><td>2024-2025</td><td>2935</td><td>2305</td><td>630</td><td>78,5%/ 21,4 %</td></tr>
</table>
<br>Evidenca 1.6 "Udhëzim Nr.29. datë 10.09.2018"<br>Evidenca 2.1 "Plani mësimor Bachelor ë Aktrim"</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 3.11 "Pasqyrat e ngarkesave Departamenti A&T"*<br>*Evidenca 4.6 mbi "Realizimine marrëveshjeve vjetore"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Në përputhje me udhëzimet që ofron Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, institucioni dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Në bazë të dokumentave të paraqitura dhe takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se UART ka një eksperiencë shumë të mirë në punësimin e një stafi cilësor me deshirë për tú kualifikuar, dhe që demonstron qëndrueshmëri në vite. Kontratat e punësimit janë të mirëpërcaktuara në detyrimet dhe të drejtat që lindin midis palëve, referuar ligjislacionit në fuqi sic dëshmohet edhe në Evidencat 4.1, 4.2, 4.3 që nga koha e fillimit të bashkëpunimit me personelin, kontratat e punës dhe listë-pagesat e detyrimeve.<br><br>*Evidenca 4.1 "Koha e fillimit të bashkëpunimit me personelin"*<br>*Evidenca 4.2 "Kontratat e punës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme"*<br>*Evidenca 4.3 "Listë pagesat e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme"* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Procedura e rekrutimit të personelit zhvillohet në përputhje me legjislacionin e përshtatshëm të UART. Për të siguruar një proces transparent dhe të drejtë, kriteret specifike përcaktohen me kujdes, dhe përpjekjet janë të ndërmarra gjatë gjithë procesit të rekrutimit për të gjetur një kandidat sa më afër nevojave të Departamentit. Ky i fundit ka të drejtën të hartojë dhe kriteret për rekrutimin e stafit akademik dhe të jetë udhëheqës në vendimarrjen lidhur me këtë proces.<br>Kriteret publikohen në faqen online të UART në këtë adresë:http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=604&niveli=154. Gjatë vizitës së GVJ në institucion pamë nga afër të gjithë procedurën dhe respektimin e afateve për shpalljen e vakancave. Përzgjedhja e stafit bëhet në referencë të kritereve të përcaktuara.<br><br>*Evidenca 4.4 "Dosja e praktikës së punësimit në A&T"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe | UART për realizimin e programeve të lëndëve mbështetet te njësitë ndihmëse të cilat luajnë një rol të rëndësishëm, si struktura mbështetëse të përcaktuara që ndihmojnë institucionin. Këto struktura mbështetëse janë të përcaktuara në strukturën e UART. Ato angazhohen në ndihmë të procesit mësimor përmes zhvillimit të punëve të laboratorit, ndjekjen e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtjen e bazës laboratorike etj. |

| | |
|---|---|
| për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Gjatë vizitës së GVJ në institucion u njohëm me strukturën administrative dhe ndihmës akademike të përberë nga: Sekretaria e Fakultetit, Sekretar/e Specialist për kurrikulën dhe informimin e studentëve, Kryetari i Degës së FAS, Specialistët (laborantët) e Fakultetit dhe punonjësit e shërbimit.<br><br>*Evidenca 4.5 "Listë e stafit ndihmës akademik Aktrim"* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi pë rmbrojtjen e të dhënavepersonale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semester dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Institucioni, përmes Sektorit të shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokolli, si pjesë e Drejtorisë së shërbimeve ndihmës-akademike administrative (si strukturë përgjegjëse), mbledh, ruan dhe përditëson rregullisht të dhënat për çdo anëtar të personelit akademik që përfshihet në realizimin e programit të studimit, si dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit. Dosja e stafit akademik pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është objekt përditësimi i përvitshëm. Veprimtaritë kryesore që kryen personeli në IAL janë:<br>-mësimdhënie<br>-kërkim shkencor ose artistik<br>-kontribut profesional<br>-kontribut institucional<br>I gjithë dokumentacioni dhe puna shkencore/artistike në fund të vitit akademik dorëzohet pranë Departamentit A&T, e cila shoqërohet edhe me përditësimin e CV të stafit.<br><br>*Evidenca 1.6 "Udhëzimi Nr. 29 për ngarkesën e stafit i ndryshuar në UMASR, NR.37, 2018"*<br>*Evidenca 4.6 "Realizimi i marrëveshjeve vjetore FAS"*<br>*Evidenca 4.7 "VKM, nr. 329, datë 12.04. 2017"* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, nëmarrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike si pas | Praktika profesionale pranë UART, është e sanksionuar edhe me Statutin e Veçantë që gëzon institucioni. Drejtimi dhe ndjekja e praktikave profesionale bëhet nga personeli akademik i Departamentit A&T me kohë të plotë, I pasqyruar edhe në ngarkesën vjetore të pedagogëve në auditor.<br>Nga vizita e GVJ në institucion konfirmuam që praktikat zhvillohen në ambientet e FAS/UART ose në ambientet e partnerëve lokalë, me të cilët kanë marrëveshje si: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar Eksperimental, Metropol, Teatri I Kukullave, Cirku Kombëtar etj.<br><br>*Evidenca 3.11 "Pasqyrat e ngarkesave"*<br>*Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART"* |

| | |
|---|---|
| natyrës së programit të studimit. | |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Departamenti i A&T ka një strategji të veçantë në kuadër të Paktit për Universitetin, ku studentët të përfitojnë nga eksperienca e personelit artistik, por jo vetëm të institucioneve pritëse, duke kombinuar një koncept të ri të mësimdhënies, harmonizimin e eksperiencave në fushën akademike dhe interpretimit skenik.<br>UART ka një sere marrëveshjesh me institucione të vecanta, të cilat datojnë që prej viteve 1960, por aktualisht vijnë më të specifikuara në funksion të rritjes së cilësisë akademike.<br><br>Evidenca 1.21 *"Marrëveshjet me partnerët UART"* |
| **Konkluzione** | *Pas një vlerësimi të detajuar, GVJ konstaton se personeli akademik* është i qëndrueshëm, ka kualifikimin e nevojshëm akademik dhe përvojë artistike dhe kontribuon në funksionimin e këtij programi. Rekrutimi i stafit të ri bëhet mbi kriteret që shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.<br><br>*Programi i studimit shquhet për organizimin dhe transparencën, duke siguruar një mjedis efektiv mësimor. Procedurat e rekrutimit janë në përputhje me legjislacionin.*<br>Zyra e burimeve njerëzore ka listën e plotë të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrative për çdo semestër që pasurohet çdo vit akademik me të dhëna të përditësuara për të gjithë elementët që kërkohen nga rregulloret përkatëse.<br><br>Praktika profesionale mbikqyret nga pedagogë evfektiv dhe kryhet në FAS ose në institucionet më të cilat UART ka lidhur marrëveshje, duke ju krijuar studentëve mundësi optimale për zbatimin dhe zhvillimin e kompetencave të tyre artistike. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të | FAS për zhvillimin e procesit mësimor, vë në dispozicion mjedise të mjaftueshme. Programi I Studimit Bachelor në Aktrim, sipas RVB ka një specifikë të veçantë dhe mund të kërkojë ambiente që |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | mundësojnë praninë e individëve me një numër të gjerë (2 deri në 200). Një situatë të tillë u konfirmua edhe nga vizita e GVJ, kusalla Black-Box me dy mjedise 40 dhe 200 vende spektatorësh dhe hapësira të bollshme skenike si dhe me një infrastructure komjuterike dhe audio-vizuale, mudësonte realizimin e shfaqjeve dhe veprimtarive artistike të studentëve.<br>Gjithashtu institucioni ofronte dhe salla të tjera me kapacitet më të madh, si Sallën e Madhe të Koncerteve me kapacitet prej 600 vendesh dhe infrastructure bashkëkohore.<br><br>*Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta"* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, perms përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Departamenti disponon kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të mjaftueshme për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Mjediset mësimore që i shërbejnë këtij programi studimi, përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të gjerë dhe plotësuese për nevojat e studentëve të këtij programi.<br>Për vetë specifikën e Programit të Studimit Bachelor në Aktrim, mjetet e teknologjisë së informacionit nuk nevojiten në të gjitha lëndët (sidomos atyre speciale) dhe për rrjedhojë bëhet një shpërndarje nga Departamenti i A&T në bashkëpunim me strukturat e tjera ndihmëse, i mjediseve të mësimdhënies.<br><br>*Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta"*<br>*Evidenca 4.9 "Lista e pajisjeve në shërbim të Aktrim"* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Mjediset mësimore që shërbejnë për këtë program studimi, duke përfshirë auditorë leksionesh, seminare dhe laboratorë, janë të pajisura me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e moduleve, aftësitë teorike dhe praktike, si dhe objektivat formuese të programit të studimit në përgjithësi. Studiot dhe laboratorët e FAS/UART janë të pajisura me aparutarat e nevojshme në funksion të përmbushjes së mësimdhënies cilësore. Nga vizita e GVJ rezultoi se në pjesën më të madhe pajisjet dhe aparaturat nuk janë konvencionale, por Departamenti i A&T u mundëson studentëvetë njohin e përdorin teknologjinë më të avancuar në fushën e artit skenik në Europë.<br><br>*Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta"*<br>*Evidenca 4.9 "Lista e pajisjeve në shërbim të Aktrim"* |
| **Kriteri 4.**Institucioni I arsimit të lartë siguron së paku një laborator të | Institucioni siguron laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Salla e bibliotekës Shkencore shërben si një mundësi shumë e mirë në këtë drejtim. Nga vizita e GVJ konstatuam nga afër që Biblioteka e UART është e pajisur me kompjutera të teknologjisë së fundit, ku studentët kanë mundësi sidomos përmes fondit multimedial me programe specifike në MP3, MP4, pdf të realizojnë detyrat në fushën e artit skenik. |
| **Konkuluzione** | *Programi i studimit "Aktrim" zhvillohet në godina të UART, të cilat janë vlerësuar si të mjaftueshme për nevojat e aktiviteteve mësimore. UART ka një gjendje shumë të mirë dhe përmbush kushtet e kërkuara, duke përfshirë standardet higjieno-sanitare dhe teknike. Departamenti ofron mjediset mësimore me kapacitet infrastrukturor dhe teknologji moderne për të akomoduar studentët dhe personelin akademik. Shfrytëzimi i sallës Black Box dhe Sallës së Madhe të Koncerteve, përkatësisht me kapacitet 200 vende për të parën dhe deri 600 vende për të dytën, është një tregues i mirë i vënies në praktikë të njohurive shkencore të studentëve.*<br>*Procesi mësimor mbështetet edhe me aksesorë të tjerë teknologjikë si programe të avancuara editimi jo linear për audio, video dhe 3D, efekte speciale digitale (CGI), manipulim fotosh etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes sës tandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Biblioteka e FAS/UARTështë biblioteka më e vjetër dhe e vetme ku përfshihen koleksione mbi të gjitha fushat e Artit dhe ofron një gamë të gjerë të literaturës multidisiplinare. Ajo mbështet procesin mësimor dhe punën kërkimore artistike nëpërmjet koleksioneve dhe shërbimeve që kjo bibliotekë ofron për lexuesit dhe përdoruesit e saj.<br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që studentëve u mundësohet qasja në literaturën e lëndës përmes këtyre formave:<br>-fizikisht në bibliotekën e UART<br>-të printuar nga vetë pedagogu<br>-Përmes linkut ku gjendet materiali i parashikuar, në varësi kjo të specifikës së lëndës.<br><br>*Evidenca 2.2 "Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim"* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 4.10 "Lista e literaturës Aktrim në Bibliotekën UART"*<br>*Evidenca 4.11 "Linku për akses në leksionet e Teknikave të Produksionit Skenik)* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Biblioteka e institucionit ka ngritur një sistem të strukturuar të raportimit dhe monitorimit të cilësisë së fondit të saj, duke përfshirë atë fizik dhe online.<br>Pasurimi i koleksioneve realizohet nëpërmjet mbështetjes nga fondi i Universiteteve të Arteve, dhurimeve, projekteve dhe donacioneve nga Fondacione të ndryshme si Shoqëria e Hapur, Trast Albania-June Emerson si dhe Fondacioni Arsimi. Gjatë vizitës në institucion pamë nga afër shërbimin në 3 fonde: Fondi I hapur, I mbyllur dhe multimedial në MP3, MP4 dhe Pdf.<br><br>*Evidenca 4.10 "Lista e literaturës Aktrim në Bibliotekën UART"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Institucioni ofron shërbimin në bibliotekë si burime të disponueshme për studentët e programit të studimit.<br>Gjatë vizitës së GVJ, biblioteka shkencore e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet këtyre ambienteve:<br>Literaturë referenciale<br>Literaturë të muzikës<br>Periodikun koherent<br>Literaturë të Artit Skenik<br>Literaaturë prej burimeve elektronike<br>Akses në internet<br>Për këtë qëllim, secili student disponon një kartelë personale elektronike të përdoruesit. Janë 1000 kartela me pedagogë, studentë dhe punojës që shfrytëzojnë literaturën e kësaj biblioteke. (Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion.)<br>Salla është komode dhe në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve e studiuesve të artit.<br>Ofrohet akses në arkivën digjitale të Bibliotekës së UART përmes:<br>-Stacioneve individuale të punës për studentët<br>-Dy Serverace që përmbajnë fondin multimedial të Bibliotës Shkencore<br>- Stacioneve tëmësimdhënies për personelin akademik.<br>Kjo sallë përvec arkivës digjitale e krijuar përmes adaptimit të sistemeve "open-source", disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në shirita me bobina, pllaka gramafoni, kaseta, CD e DVD.<br><br>*Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion*<br>*Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digitale"* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond | Biblioteka e UART ofron një gamë të gjerë literature me qasje multidisiplinare për studentët. |

| | |
|---|---|
| fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Botimet aktuale ofrojnë qasje personale drejt një psikologjie të caktuar artistike të cilën programi ia ofron si mundësi njohjeje studentëve, por në respect të lirësë artistike dhe krijuese, jo detyrimisht duhet të përqafohet nga studentët. Lista e literaturës së detyrueshme është e përcaktuar qartë në Syllabuset e lëndës. Literatura më e fundit ofrohet në gjuhë të huaja në pjesën më të madhe pasi ka një mungesë tregu për botime të mirëfillta artstike/pedgogjike në gjuhën shqipe.<br>Nga vizita në isntitucion na u konfirmua që Departamenti I A&T ka mundësuar përmes pedagogëve të saj përkthimin e kolanave të klasikëve të mendimit teorik dhe praktik të skenës. Ky është një tregues I rëndësishëm I ofrimit të të gjitha kapaciteteve për një shërbim akademik cilësor në shërbim të studentëve.<br>Ashtu sic është përmendur dhe më lart, Biblioteka e UART ofron koleksionet dhe shërbimet e saj në Sallën me Fond të Hapur, e cila ofron një literaturë të pasur edhe prej burimeve elektronike të huaja, akses në internet; por mbi të gjitha I jepmundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë duke fotokopjuar vetëm disa faqë që iu intereson.<br>-Salla me Fond të Mbyllur, ofron përvec literaturës së përgjithshme, edhe punime teorike të studiuesve dhe studentëve, literaturë muzikore, parte instrumentale dhe vokale, partitura orkestrale etj.<br><br>*Evidenca 4.10 "Lista e Literaturës Aktrim në Bibliotekën UART"*<br>*Evidenca 4.13 "Lista gjithëpërfshirëse në Bibliotekën UART* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Institucioni ka ndërmarrë hapa për të siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online që lidhen me fushën e programit të studimit, siç tregohet në (Evidencën 4.12). Të gjithë studentët, por jo vetëm kanë mundësi të përdorin arkivën digjitale të aksesueshme e krijuar nëpërmjet sistemit me bazë "kod me burim të hapur", e cila ofron akses të brendshëm, kombëtar dhe ndërkombëtar. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Nga Vizita e GVJ në institucion u konstatua se biblioteka është e pajisur me kompjuterë të cilët ofrojnë studentëve mundësi aksesi me dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library". Kjo e fundit është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet dhe softëerë specifikë në mbështetje të punës studimore/artistike. Këtu mund të punohet me editim jo-linear video/montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn inxhinierik etj.<br>Shërbimet elektronike të Bibliotekës Shkencore të Universitetit uart.edu.al/katalog_biblio<br>http://imslp.org/http://arkiv.uart.edu.al/https://about.jstor.org/educat |

| | |
|---|---|
| | ors/ ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve të zbatuara gjatë viteve 2011/2012, të cilat janë 1) sistemi i menaxhimit të integruar përmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin elektronik të fondit fizik të titujve të disponuar, kartelave elektronike, qarkullimin, etj, si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) dhe 2) sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale).<br><br>*Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion*<br>*Evidenca 4.12"Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digitale"* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e UART funksionon mbi bazën e Statutit, Neni 21 i tij dhe Rregullores së Bibliotekës. Ofron shërbim nga punonjësit e saj për studentët dhe personelin akademik gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premten (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8:00—19:00. Kjo kohë përshtatet me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përballohet me numrin e studentëve dhe kapacitetin e saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrjen e Bibliotekës. Për çdo student, është e mundur të disponojë një kartelë personale elektronike për të përdorur shërbimet e bibliotekës.<br><br>*Bazuar në Vizitën e GVJ në Institucion*<br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART"* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë | Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit që ndjekin dhe raportojnë mbi cilësinë e fondit fizik dhe online, duke përfshirë titujt kryesore në shërbim të programit studimor. Përmbledhja përfshin aspektet e përditësimit, shkallën e shfrytëzimit nga personeli akademik dhe studentët, përdorimin e sallave të studimit, dhe përpjekjet për pasurim të fondit fizik dhe online.<br>Kërkesa për shtimin e fondit me literaturë vjen nga Departamenti i A&T referuar nevoja që ky program studimi ka.<br><br>*Evienca 4.10 "Lista e Literaturës Aktrim në Bibliotekën UART"*<br>*Evidenca 4.12 "Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale"*<br>*Evidenca 4.15 "Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART* |

| | |
|---|---|
| kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | |
| **konkluzione** | *Biblioteka e UART është biblioteka më e vjetër dhe e vetme ku përfshihen koleksione mbi të gjitha fushat e artit. Gjithë fondi, koleksionet që disponon dhe shërbimet që ofron i shërbejnë edukimit artistiko-muzikor, skenik dhe pamor. Udhëhiqet me moton që biblioteka universitare është vendi ku studenti mendon në mënyrë kritike dhe kreative mbi burimet e informacionit. Ka një numër të konsiderueshëm përdoruesish (1000 përdorues). Pasurohet vazhdimisht me tituj shkencorë, monografi, literaturë shkencore, revista shkencore në funksion të kërkesave dhe përmbushjes së procesit mësimor. Përdor platforma moderne për akses online të literaturës përmes automatizimit dhe digjitalizimit që nga viti 2011.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon system të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Bazuar në informacionin e prezantuar, organizimi administrativ në FAS/UART ka një sekretari të veçantë, ku institucioni mban regjistra të rregullt me të dhëna specifike mbi regjistrimin e studentëve, numrat e matrikullimit, dhe informacione tjera, duke filluar nga dita e regjistrimit deri në diplomim. Ky proces i dokumentimit është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, siç përcakton Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nr. 9887, datë 10.03.2008, siç është evidentuar edhe nga vizita në institucion.<br>Studentët aksesojnë cdo informacion online në adresën http://www.art.edu.al/ . Përdoret sistemi i brendshëm PITAGORA, libreza elektronike e notave për studentët.<br>Në sekretari gjatë vizitës konstatuam nga afër me modele:<br>Regjistrin themeltar të studentëve<br>Regjistrin e arritjeve akademike<br>Procesverbale të notave<br>Regjistrin e lëshimit të diplomave<br><br>Evidenca 4.16 " VSA nr. 23, datë 07.10.2015- mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART" |

| | |
|---|---|
| | Evidenca 1.16 "VSA nr. 23, datë 07.10.2015- mbi miratimin e Rregullores të Funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART"<br>*Evidenca 3.13 "Screenshot nga Sistemi Pitagora"* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>**Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në Statutin e UART, Neni 61 si dhe dosjet e personelit nga vizita e GVJ në institucion, dokumentacioni lidhur me aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, nga momenti i tyre i rekrutimit e deri në vazhdimësinë e angazhimeve, menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo drejtori kujdeset për administratën dhe arkivimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme. Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretarisë Protokoll në kuadër të kësaj drejtorie ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e dokumentacionit. Dosjet personale përmbajnë informacione të tilla si kontratat e punës, diplomat dhe tituj akademikë, CV-të dhe të dhëna të tjera relevante për arritjet akademiko-shkencore të personelit. Kjo përfshin një përqasje efikase dhe të rregullt të dokumentacionit që lidhet me profilin dhe kontributin e secilit anëtar të personelit në institucion. Referuar dhe Udhzimit Nr. 29, datë 10.09. 2018 dhe VKM Nr. 329, datë 12.04.2017, vec të tjersh kërkon dhe realizimin e aktiviteteve artistike-shkencore në përputhje me akt marrëveshjen të cilat bëhen pjesë e sistemit të menaxhimit të brendshëm të dokumentacionit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti i UART URDHËR MINISTRI NR. 319 PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË UART DHE STATUTI"*<br>*Evidenca 1.6 "Udhëzimi NR. 29 për ngarkesën e stafit, I ndryshuar me UMASR Nr.37, 2018"*<br>*Evidenca 4.7 "VKM nr.329, datë 12.04.2017"* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platform dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Personeli akademik dhe studentët të FAS përdorin përveç faqes zyrtare dhe postës elektronike edhe disa platforma elektronike të tjera sic është sistemi i integruar PITAGORA (i ofruar nga RASH), e cila sguron këmbimin e informacionit mes studentëve, sekretarisë FAS dhe pedagogëve. Ky sistem pasqyron vlerëimin e studentit në kohë reale në adresën personale të tij/saj; njoftimin rreth datave të provimeve; shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme; informimin mbi lëndët kaluese etj.<br><br>*Evidenca 4.19 "Manuali PITAGORA"*<br>*Evidenca 3.13 "Screenshot nga sistemi PITAGORA"* |
| **Kriteri 5.** Sistemi I menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të | Platformat elektronike sigurojnë një monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sipas nevojave, këto sisteme ofrojnë mundësi për raportime individuale në lidhje me |

| | |
|---|---|
| aktivitetit akademik e administrative dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | përparimin akademik të studentëve dhe afatet e vendosjes së vlerësimeve nga personeli akademik. Për vetë specifikën e vecantë që ka, UART funksionon me një Rregullore tëvecantë, miratuar me VSA Nr. 07, dt. 09/10/2024, ku stafi akademik i cili ka nevojë për leje të vecantë, në përfundim të aktivitetit ka detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit justifikues dhe të një raporti narrativ.<br><br>*Evidenca 4.20 "Fletëprezenca të pedagogëve në orën e mësimit"*<br>*Evidenca 4.21 "Kërkesa e pedagogut për leje, krijimtari apo aktivitet"*<br>*Evidenca 4.22 "VSA, nr.7, datë 9.10.2024- Regullore e Lejeve"* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dygjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | UART ka faqen online http://www.uart.edu.al për të informuar studentët, ish-studentët dhe komunitetin për veprimtarinë e saj. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare përfshin detaje rreth programit të studimit, misionit, planit mësimor, strukturës mësimore, orarit etj. UART përdor dhe rrjetet e tjera sociale për të informuar publikun në rastet e aktiviteteve të ciat kanë përmbajtje në më shumë se një gjuhë.<br><br>*Evidenca 4.5 "Listë e stafit ndihmës akademik AKTRIM"* |
| **Konkluzione** | *UART ka një organizim administrativ efikas dhe të plotësuar duke pasur sekretarinë. Dokumentacioni i personelit administrativ dhe akademik menaxhohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Dokumentacioni i institucionit është i qasshëm për personelin akademik dhe studentët, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit (Vizita e GVJ në institucion).*<br>*Përdorimi i platformës elektronike PITAGORA, siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Njësia Bazë ka një faqe interneti dhe një faqe në Facebook për komunikim të ndryshëm me studentët dhe komunitetin, duke ofruar informacion në gjuhën shqipe dhe angleze, përfshirë detaje mbi programin e studimit, misionin, planin mësimor, orarin, kalendari i provimeve, si dhe* informacion mbi personelin akademik. Këtu përfshihen dhe promovimi i aktiviteteve artistike që organizohen nga FAS në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera. Ka shumë mirë të menaxhuar edhe raportimin në kohë reale për stafin akademik/administrativ përmes një Rregulloreje të vecantë, miratuar me VSA Nr. 07, dt. 09/10/2024, cka mundëson transparencë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në informacionin e prezantuar, UART zhvillon një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbajtjen e programeve të studimit. Administratori i UART harton projektin e buxhetit vjetor, duke u bazuar në propozimet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, të mbështetura në Planin Strategjik të zhvillimit të UART-së dhe Planin buxhetor afatmesëm.<br>Burimet e financimit të Departamentit A&T vijnë në formë granti nga buxheti i shtetit, të ardhurat e krijuara nga institucioni dhe burime të tjera me destinacion. Ky projekt buxhet miratohet në Senat dhe Bordi i Administrimit, i cili përcillet për miratim. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Ky proces është pjesë e strukturave qendrore të menaxhimit financiar të UART-së dhe njësive bazë. Këto struktura kontribuojnë përmes propozimeve dhe kërkesave për veprimtari, projekte, botime, pasurim të bibliotekës, abonime, dhe aktivitete të tjera që nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e mbulimit financiar të procesit akademik në auditor. Propozimet dhe kërkesat e tyre dërgohen në përputhje me përcaktimet ligjore, nevojat, dhe planet strategjike të zhvillimit të institucionit. Miratimi i kërkesave përcaktohet në buxhetin e finalizuar, duke pasqyruar nevojat dhe interesat e institucionit.<br><br>*Evidenca 4.24 "Paraqitja e buxhetit nga administratori FAS"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyrë periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, duke përmbledhur të ardhurat dhe shpenzimet sipas kërkesave ligjore në fuqi. Raporton në mënyrë periodike pasqyrat financiare në MAS. |

| | |
|---|---|
| | UART sic dokumentohet edhe nga RVB nuk i është nësnshtruar ndonjë auditimi financiar. Ndërsa për ngritjen e auditimit të brendshëm, UART nuk i plotëson kushtet sipas VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 "për miratimin e krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në Sektori Publik". |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori paraqesin raporte periodike në Senatin dhe Bordin e Administrimit, duke raportuar për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraprak. Ky proces siguron një transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar, duke siguruar që organet vendimmarrëse të institucionit të kenë një vështrim të qartë mbi shpenzimet dhe të ardhurat aktuale.<br><br>*Evidenca 4.33 "Dokumente nga Drejtoria Ekonomike mbi raportimin për realizimin e buxhetit".* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situates financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | UART sigurohet financiarisht nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore nga studentët, duke përfshirë tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet e tjera ofruara ndaj të tretëve. Analiza financiare vjetore e institucionit fokusohet në menaxhimin e efikas të këtyre burimeve për të garantuar një qëndrueshmëri financiare. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në informacionin e paraqitur, UART ndjek një procedurë transparente për hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Administratori i UART harton projektin e buxhetit vjetor, duke përfshirë propozimet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, në përputhje me Planin Strategjik të zhvillimit të institucionit.*<br>*Ky projekt miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik. Gjithashtu, raportimi financiar i UART përfshin një analizë të kostove dhe mbështetjes financiare për programet e studimit, duke u fokusuar në një qëndrueshmëri financiare. Strukturat e menaxhimit financiar, prezantojnë propozime dhe kërkesa për veprimtari dhe projekte që kontribuojnë në pasurimin e institucionit.*<br>*Nuk i është nënshtruar auditimeve financiare dhe nuk plotëson kushtet për ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm, referuar* |

| | |
|---|---|
| | *VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në Sektorin publik:, pika 1, b.*<br>*Rekomandojmë rritjen e përpjekjeve për komunikim të qartë dhe transparent në lidhje me përdorimin e fondeve, përfshirjen e një segmenti të posaçëm për informim publik në faqen zyrtare për të ndihmuar në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komunitetit institucional dhe publikut në përgjithësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Pranimi i studentëve të rinj dhe procesi i tyre akademik në kuadër të ciklit të plotë në Departamentin A&T është ndërtuar mbi një politikë të qartë, e hartuar dhe zbatuar me respekt për kornizën ligjore aktuale dhe rregullat vendore të institucionit; Ligji nr. 80/2015 dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 "Për dhënien e Statusit të vecantë UART si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë".<br><br>*Evidenca 1.4 "VKM NR. 145, datë 10.03.2021 Statusi i Vecantë"*<br>*Evidenca 5.1 "Rregullorja e UART"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullorja e Ciklit të Parë të Studimit"*<br>*Evidenca 1.17 "Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme e Departamentit Aktrim dhe Teori"*<br>*Evidenca 1.18 "Regullorja e programit të studimit Aktrim"*<br>*Evidenca 4.16 "VSA Nr. 23 dt. 07.10.2015.19 Mbi miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve në UART"* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe dispozitat ligjore të UART-së dhe për trajtimin e studentëve, nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve, kanë si synim sigurimin e barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në programin e studimit. Ky angazhim përbën dokumentacionin aktual, praktikat aktuale, dhe përvojën afatshkurtër dhe afatgjatë. Rregullorja e Studimeve në UART, së bashku me dokumentacionin analog të njësive tjera, detajojnë me kujdes procedurat dhe praktikat për trajtimin e studentëve, duke siguruar transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë.<br>UART/FAS dhe programet e studimit që ofron, ndjekin një politikë pranimi krejt të ndryshme nga uviersitetet e tjera në vend. Studentit nuk i mjafton vetëm mesatarja e ponderuar, por duhet tëkonkurrojë përballë komisionit të pranimit për të fituar të drejtën për të qenë pjesë e UART. Për këtë studenti duhet të zotërojë aftësi shtesë, të shfaqë shenja të dhuntive që zotëron, vizion për ta bërë procesin e pranimit sa më të hapur dhe transparent.<br><br>*Bazuar në vizitën në institucion dhe faqen online të UART/Kriteret e konkurimit FAS 2021-2022; 2022-2023; 2023-2024* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteretparashikojnëedheregjistrimin e studentëvetëhuaj. | Institucioni aplikon një proces transparent për pranimin e studentëve, duke publikuar kriteret dhe kuotat në faqen zyrtare para fillimit të vitit akademik. Këto kritere janë në përputhje me VKM-të aktuale dhe aprovohen nga Dekanati dhe Senati Akademik. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurentëve, me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit përcillen nga Departamenti i A&T drejt Dekanatit te FAS dhe miratohen në Senat.<br>Ka një rregullore specifike që hartohet cdo fillim viti akademik për studentët që i nënshtrohen konkurseve të pranimit. Për një konkurs sa më transparent dhe cilësor, Dekani i FAS me anë të një urdhri të posacëm ngre grupin e punës dhe përcakton detyrat dhe afatet në zbatim të akteve nënligjore për konkurset e pranimit.<br><br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e programit të studimit Aktrim"*<br>*Evidenca 5.2 "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve Bachelor 2021-2022"* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 5.3 "Rregulloret dhe kriteret Bachelor 2022-2023"*<br>*Evidenca 5.4 "Rregulloret dhe kriteret Bachelor 2023-2024"* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | UART ka implementuar mekanizma efikase për të përcjellë informacionin lidhur me kriteret, procedurat e pranimit, transferimin e studimeve dhe diplomimin në faqen zyrtare https://www.uart.edu.al.<br>FAS/Departamenti A&T ofron mundës për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve për programet e të njëjtit cikël studimi, në fusha të përafërta brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.<br><br>*Bazuar në vizitën në institucion*<br>*Evidenca 1.15 për Rregulloren e studimit të ciklit të I-rë Bachelor në UART, nenet 24-25* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | UART/ FAS/A&T ndjek një praktikë të zakonshme në publikimin e kritereve dhe kërkesave për programet e studimit para fillimit të vitit akademik. Kjo përfshin një gamë të gjerë të mjeteve komunikuese, duke filluar nga faqja zyrtare e UART-së dhe duke përfunduar me kontakte direkte me individë dhe grupe të interesuar përmes takimeve të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet bachelor. Cdo njoftim publikohet në faqen zyrtare të UART, duke rritur ndjeshëm transparencën me cdo student dhe publikun e gjerë.<br><br>*Evidenca 1.15* "Rregullore e studimit të ciklit të I-rë Bachelor në UART"<br>*Evidenca 5.2 "Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve në Bachelor 2021-2022"*<br>*Evidenca 5.3 "Rregulloret dhe kriteret Bachelor 2022-2023"*<br>*Evidenca 5.4 "Rregulloret dhe kriteret Bachelor 2023-2024"*<br>*Evidenca 5.5 "Urdhër i Dekanit FAS për ngritjen e komisioneve të pranimit 2022-2023"*<br>*Evidenca 5.6 "Urdhër i Dekanit FAS për ngritjen e komisioneve të pranimit 2023-2024"*<br>*Evidenca 5.7 "Urdhër i Dekanit FAS për ngritjen e komisioneve të pranimit 2024-2025"* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik | UART, si institucioni i vetëm që ofron studime të larta në fushën e artit dhe ka në thelb parimin e meritës dhe talentit, |

| | |
|---|---|
| kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | nuk harton kritere të posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësitë veçanta apo të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara, por përcakton kuota të veçanta për këto shtresa. Në A&T/FAS nuk parashikohen kuota për studentët me aftësi të kufizuara, kjo për vetë specifikën e programit, e cila kërkon një fizikalitet dhe aftësi koordinimi shqisor shumë të mprehtë për tu përballur në skenë dhe prapaskenë në trupën teatrore. Për kategorinë e Romë/Ballkano Egjyptianë ndiqet një politikë mbështetëse.<br><br>*Evidencë 2.4 "VKM 251 27.03.2020 Përjashtimi nga tarifa të studentëve Romo-Ballkano-Egjyptianë".* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Institucioni, në përputhje me rregulloren e programit të studimit, përgatit dhe publikon çdo vit kriteret për përzgjedhjen e studentëve, por jo enkas për shtetas të huaj. Për studentët nga këto shtete, ofrohet mundësia e konvertimit të diplomave dhe ekuivalentimit të lëndëve, sipas dispozitave të Statutit të institucionit. Studimet në UART mund t'i ndjekin edhe shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.<br><br>*Evidenca 1.15 " Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART"* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomimik të vendit. | Institucioni, në përputhje me legjislacionin aktual, harton politika për bursa dhe ofron mbështetje financiare për shtresat në nevojë. Ky angazhim përfshin uljen e tarifës së studimit, rritjen e cilësisë së pranimit në programe prioritare, dhe kontributin në zhvillimin ekonomik të vendit. Kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, ndryshojnë cdo vit akademik.<br><br>*Evidenca 5.11 "VKM 780, dt.26.12.2018, kritere për ulje vjetore të tarifës së studimit"*<br>*Evidenca 2.4 "VKM 251, 27.03.2020 Përjashtimi nga tarifa të studentëve Romo-Ballkano-Egjiptianë"*<br>*Evidenca 5.12 "VBA 4 , dt 16.02.2023 Reduktimi i tarifave të shkollimit"* |

| Konkluzione | *UART implementon një politikë të qartë dhe transparente për pranimin dhe zhvillimin akademik të studentëve, të bazuar në legjislacionin vendas dhe Statutin e institucionit. Përcaktimi I kuotave dhe kritereve nga Njësitë Bazë, I harmonizuar me VKM-të aktuale, ndodh një vit para fillimit të vitit akademik. FAS/A&T përcakton kuotat dhe kriteret e veta, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të UT. Politikat dhe dispozitat për trajtimin e studentëve janë në përputhje me ligjin dhe promovojnë barazi dhe drejtësi. Statuti dhe Rregullorja e Studimevenë UART rregullojnë trajtimin e studentëve dhe sigurojnë informacion të aksesueshëm për kandidatët nëpërmjet Mjeteve të Komunikimit Publik.*<br>*UART/FAS/A&T kanës pecifikën e konkurimit perms meritës dhe talentit dhe formimit të përgjithshëm të studentit, duke kaluar në process të hapur konkurimi dhe vlerësimi.*<br>*Institucioni gjithashtu zbaton mekanizma efikase për publikimin e informacioneve në faqen zyrtare, duke përdorur një game të gjerë të mjeteve komunikuese dhe bashkëpunimin me strukturat kompetente, duke treguar kujdes të vecantë lidhur me promovimin dhe ofrimin e informacioneve të duhura për aspirantët student në programet e studimit.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik nët jetrin. | Rregullorja institucionale dhe programet e studimit ofrojnë informacion për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve .<br>Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, kritere dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve etj.<br>Studentët marrin informacion përmes sekretarisë mësimore, faqes sëëeb-it të UART dhe sistemit PITAGORA. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 1.16 " VSA 35, dt. 07.12.2021për Miratimin e Rregullores së veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik"*<br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Aktrim* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Referuar Rregullores së programit të studimit, pjesë e kritereve është konkursi/talenti i kandidatit për student. Cdo kandidat ka të drejtën e konkursit, edhe kur gëzon një diplomë të huaj dhe është ekuivalentuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Por studimet mund ti ndjekin edhe shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të UART.<br><br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e programit të studimit Aktrim"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Departamenti i A&T, përmes Sekretarisë mësimore të FAS informon studentët në fillim dhe gjatë vitit akademik rreth kritereve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve për çdo lëndë dhe program studimi. Ky informacion përfshin sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, kontrollin e dijeve, kushtet për hyrjen në provim, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe mundësitë për përmirësimin e notave.<br>Në FAS mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla ose të mëdha për lëndët artistike. Në këto kushte edhe vetë pedagogët informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët për cdo detaj të kritereve të vlerësimit të tyre në programin e studimit dhe lëndët përkatëse.<br><br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e programit të studimit Aktrim"* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Departamenti në mënyrë të vazhdueshme jep informacione të detajuara lidhur me përgatitjen e diplomës dhe procesin e diplomimit. Në takimet me studentët, u shpërndahen tematikat e sugjeruara për t'u zgjedhur prej tyre për diplomim, si dhe u shpjegohen procedurat e punimit të temës së diplomës, politikat mbi plagjiaturën, pronësinë intelektuale dhe mënyrat e citimit e referimit, deri te caktimi i pedagogut udhëheqës.<br><br>*Evidenca 1.18 "Rregullorja e programit të studimit Aktrim"* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni I arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve | UART organizon takime të hapura me kandidatë për studentë. Synohet informimi i nxënësve që kur janë në shkollë të mesme për ti nxitur që të mund të ndjekin talentin e tyre në fushën e përzgjedhur. Kanë mundësi të njihen me institucionin, strukturën, programet dhe produktin artistik.<br>Open DAY përbën një risi, duke hapur dyert për të ndjekur nga afër punën dhe aktivitetet e përditshme të stfit akademik dhe studentëve të UART. |

| | |
|---|---|
| e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | UART ka struktura të vecanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, duke promovuar punën përmes rrjeteve sociale si Facebook, Linkedin, Youtube, Instagram. |
| **Konkluzione** | *UART ofron informacion të detajuar për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. Në fillim të vitit akademik, studentët marrin informacion në lidhje me procesin mësimor dhe orarin e mësimeve në faqen zyrtare. FAS/A&T informon rregullisht studentët për procedurat e vlerësimit të dijeve. Studentët në programin e studimit Bachelor në "Aktrim" mund të diplomohen me provim përfundimtar ose punim diplome, dhe procedurat janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Para fillimit të vitit akademik dhe periodikisht, UART organizon takime për informimin e maturantëve. Njësia Bazë ruan marrëdhëniet informuese me drejtoritë e shkollave dhe organizon takime informuese për studentët, duke i përfshirë në aktivitete të ndryshme.* ***Vlen të theksohet se studentët bëhen pjesë e shumë projekteve gjatë studimeve të tyre dhe ky Departament historinë e suksesit e ka pikërisht në angazhimin e studentëve ku ftohen të japin kontributin e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.*** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët informohen në detaje për strukturën, organizimin, dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes Rregullores së Studimeve në UART, Rregullores së UART-së, si dhe Rregullores së Programit të Studimit Bachelor në "AKTIRM", dhe përmes takimeve informuese, sqaruese dhe orientuese, fletëpalosjeve, posterave. Gjatë ditëve të pritjes me maturantët organizohen takime informuese me shkollat e mesme sidomos atyre me profil artistik. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik, organizohen takime informuese me studentët e vitit të parë të studimeve. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për | Në fillim të çdo viti akademik dhe në vijim, A&T i ofron studentëve të programit të studimit Bachelor në "Aktrim" çdo informacion, udhëzim dhe rregullore që i siguron studentit personalitet dhe autoritet, duke përfshirë njohjen e plotë me programin, planin mësimor, lëndët dhe përmbajtjen e tyre, si dhe gjithë veprimtaritë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | formuese në ciklin e studimeve. I gjithë infornacioni është i publikuar në faqen zyrtare të UART. \|<br><br>*(faqja web e Departamentit A&T)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | FAS/Departamenti i A&Te ka mision orientimin e studentëve me mundësitë që ofron tregu i punës në profilet e tyre të studimit.<br>Ato përfshihen në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në shfaqje dhe aktivitete të tjera teatrore në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" dhe Teatrin e Metropolit.<br>Vecantia e këtij institucioni që numri i studentëve është i vogël, bën që informacioni dhe bashkëpunimi profesional të jetë gjithmonë në nivele shumë të mira.<br><br>Evidenca 1.21 *"Marrëveshjet me partnerët UART"* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacioni gjerë dhe I përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Njësia Bazë ofron te studentët informacion të plotë dhe të përditësuar lidhur me strukturën mësimore, planin mësimor, orarin e mësimeve, kalendarët e provimeve, dhe njoftimet përmes disa kanaleve, duke përfshirë stendën e Informimit pranë Njësisë Bazë, sekretarinë mësimore, faqen zyrtare të internetit, postën elektronike personale dhe rrjetet sociale.<br><br>*Evidenca 2.2 "Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim"*<br>*Faqja zyrtare online* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet perms sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht I arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë për studentët përmes disa kanaleve, duke përfshirë faqen zyrtare të internetit të UART, postën zyrtare elektronike dhe sistemin e sekretarisë mësimore. Studentët e programit të studimit bachelor në Aktrim, aksesojnë sistemin PITAGORA përmes aksesit që ato kanë në email e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në cdo kohë. Qasja e studentëve në mësim mund të realizohet edhe nëpërmjet sistemit Microsoft Teams.<br><br>*(Bazuar në vizitën në institucion dhe faqen ueb të institucionit)* |
| **Konkluzione** | *Studentët informohen përmes rregulloreve të institucionit dhe programit, duke përfshirë njohjen me lëndët, planin mësimor dhe aktivitetet formuese. Departamenti A&T ofron informacion të plotë për studentët e programit të studimit Bachelor në "Aktrim", përfshirë programin dhe planin mësimor. Njësia Bazë siguron informacion lidhur me strukturën mësimore dhe njoftimet përmes kanaleve të ndryshme. Informacioni për programin e studimit është lehtësisht i arritshëm për studentët në distancë përmes faqes zyrtare, postës elektronike dhe sistemit të sekretarisë mësimore.* |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">Edhe nga vizita e GVJ në takimin me studentët na rezultoi se të gjithëkishin shumë informacion për programin e studimit.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td></td><td></td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</td><td>Sekretaria mësimore e FAS bashkë me Departamentin A&T mbajnë të dhëna sistematike vjetore lidhur me numrin e studentëve të diplomuar në cdo program studimi. Tabela e gjeneruar nga sekretaria ofron të dhëna lidhur më numrin e studentëve të regjistruar, ata të diplomuar, notën mesatare në fillim të studimeve dhe notën mesatare në përfundim të tyre si dhe studentët e transferuar gjatë viteve akademike. Edhe nga vizita në institucion i GVJ u bë e mundur ofrimi i të gjithë dokumentacionit lidhur me këtë.<br><br>Bazuar në vizitëne GVJ<br>Evidenca 5.14 “Statistika e FAS për numrin e studentëve dhe të Diplomuarve 2022-2025”</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet program i studimeve.</td><td>FAS dhe A&T ka në dispozicion statistika vjetore të detajuara për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, duke përfshirë tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, dhe diplomimin e tyre. Të dhënat mbahen edhe për studentët që c’rregjistrohen nga programi.<br>Numri studenteve për 3 vitet e fundit akademike:
<table>
<tr><td>2022-2023</td><td>10</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>11</td></tr>
<tr><td>2024-2025</td><td>9</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>30</td></tr>
</table>
<br>Bazuar në vizitëne GVJ .<br>Evidenca 5.14 “Statistika e FAS për numrin e studentëve dhe të Diplomuarve 2022-2025”</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen permes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta</td><td>Përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit elektronik PITAGORA, UART menaxhon të dhënat statistikore të studentëve, duke përdorur një kombinim të metodave manuale dhe elektronike. Ky proces siguron sigurinë dhe zbatimin e rregullave ligjore. Të dhënat e statistikave janë lehtësisht të gjetshme për personat e autorizuar. UART rezulton ndër institucionet e para të Arsimit të Lartë Publik i</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | cili ka implementuar sistemin online të hedhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave.<br><br>*Evidenca 3.13 "Screenshot nga sistemi PITAGORA"* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodic të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dh esaktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Njësitë përbërëse të UART kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me aktet. Përmes kontrollit periodik, UART vlerëson dokumentacionin në Njësitë bazë, kryesore dhe Sekretarive mësimore, duke dokumentuar situatën dhe siguruar saktësinë e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre.<br>Cdo gjë funksionin mbi bazën e rregulloreve përkatëse.<br><br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e sistemit mësimor UART"* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit tët yre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Cdo vit Departamenti A&Tharton një raport vjetor për mbarëvajtjen, performancën, diplomimin e studentëve dhe përfshirjen e tyre në nivelin e dytë të studimeve. Ky informacion përdoret për analizën vjetore të institucionit dhe paraqitet në raportin vjetor. Departamenti në bashkëpunim me zyrën ALUMNI ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e mëtejshme për paraqitjen e mundësive përpunësim.<br><br>*Evidenca 1.25"Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite* |
| **Konkluzione** | *UART/FAS siguron statistika vjetore për programin e studimit Bachelor në "Aktrim". Menaxhimi i këtyre të dhënave zhvillohet përmes Sekretarisë Mësimore dhe sistemit elektronik Pitagora, duke garantuar zbatimin e rregullave ligjore.*<br>*Departamenti A&T, në kuadër të veprimtarisë së saj, analizon të dhëna mbi profilin, cilësinë dhe punësimin e studentëve, duke hartuar raporte dhe strategji përmirësimi. Këto raporte integrohen në dokumentacionin më të gjerë të FAS dhe UART-së, duke përfshirë raportet e Fakulteteve, Sekretarive Mësimore, Zyrës së Alumni etj. Ky proces monitoron dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve të ofruara nga UART, duke prezantuar rezultatet në raporte periodike.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Kuadri ligjor për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në vendin tone përcakton në një nen të veçantë të drejtën e studentëve për tu organizuar në Këshilla Studentorë, si organizime të pavarura që përfaqësojnë interesat e tyre. (EvidencaLigji Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 59, Këshillat e Studentëve).<br>Me miratimin e Statutit të ri të UART, të MASR Nr 3937/5, datë 15.09.2021, me VSA Nr 15, datë 30.08.2021, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik prej 19 anëtarësh me 2 studentë, Këshilli i Etikës me 1 student, Këshilli Studentoretj.<br><br>*Evidenca 1.1 "Ligji 80/2015 22.07.2015*<br>*Evidenca 1.5 "Statuti UART Urdhër Ministri Nr. 319 për Miratimin e Statutit të UART*<br>*Evidenca 1.16 "VSA 35, dt. 07.12.2021 për miratimin e Rregullores së veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Artit Skenik"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëvedhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Bazuar në Statutin e tij, UART siguron përfshirjen e studentëve në procese vendimmarrëse dhe vlerësuese mbi aspektet akademike dhe administratë. Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik shprehin mendime dhe propozime për çështje të përgjithshme akademike. Studentët organizohen në Këshillat Studentore dhe janë pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit. Ata janë pjesë e Këshillit të Etikës dhe marrin pjesë aktivisht në sondazhe vjetore të studentëve.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti UART Urdhër Ministri Nr. 319 për Miratimin e Statutit të UART"*<br>*Evidenca 1.16 "VSA 35, dt. 07.12.2021 për miratimin e Rregullores së veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Artit Skenik"* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe | UT, në përputhje me Statutin dhe aktet rregulluese, inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe vlerësuese. Studentët kanë të drejtë të shprehen në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë planet dhe programet e |

| | |
|---|---|
| përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | studimeve, cilësinë e shërbimeve, tarifat, dhe kontribute financiare.<br><br>*Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga sektori mësimor"*<br>*Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"*<br>*Evidenca 1.9.1 "Urdhri i Dekanit Prof. Miltiadh Kutali Nr. 03.02.2025 për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm në kuadër të akreditimit Bachelor FAS"*<br>*Evidenca 5.17 "VSA Nr. 22 dt. 07.10.2021 Mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Komisionit të marrëdhënieve më studentët në UART"* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës. | Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, duke përfshirë ankimimin e rezultateve nga studentët, është përcaktuar në të gjitha Rregulloret institucionale.<br>Gjatë vizitës së GVJ në institucion, studentët ishin shumë të kënaqur me transparencën e treguar nga pedagogët për mënyrën e vlerësimit të tyre. Cdo vlerësim bëhej me pikët përkatëse, komentet dhe në rast të ndonjë pakënaqësie, studentët kanë të drejtën të ankimojnë notën.<br><br>*Evidenca 1.16 "VSA 35, dt. 07.12.2021 për miratimin e Rregullores së veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Artit Skenik"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART"* |
| **Konkluzione** | *UART inkurajon pjesëmarrjen aktive të studentëve në organet kolegjiale dhe proceset vendimmarrëse duke i përfshirë në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, komisionet zgjedhore dhe vlerësuese, si dhe Këshillin Studentor. Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e tyre në çështjet akademike dhe administrative, duke u mundësuar të shprehen në lidhje me planet e studimit, cilësinë e shërbimeve, tarifat dhe kontributet financiare. Për sa i përket procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ato realizohen me shumë korrektesë nga pedagogët e lëndëve përkatëse duke iu përmbajtur një procesi shumë transparent ndaj studentëve, gjë që e konstatuam edhe nga vetë deklarimet e këtyre të fundit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi V.6** |

| **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësitë posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Studentët në këtë program studimi, por edhe në rang Fakulteti informohen dhe asistohen lidhur me problematika apo orientime të programit të studimit. Studentët e diplomuar në Universitetin e Arteve janë të gjithë artiste të mirëfilltë si dhe specialist të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. Kontributi i tyre në fushën e artit është i pazëvendësueshëm.<br><br>*Evidenca 4.16 "VSA Nr. 23, dt. 07.10.2015 mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Sektretarive Mësimore të Fakulteteve në UART"*<br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e sektorit mësimor UART"*<br>*Evidenca 5.17 "VSA Nr. 22 dt. 07.10.2021 mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të komisionit të marrëdhënieve me studentët në UART"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një system të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Studentët informohen, këshillohen, ndiqen dhe informohen nëpërmjet disa burimeve në UT. Njësia bazë, përgjegjësit, titullarët e lëndëve dhe stenda e Informimit ofrojnë shërbime në këtë drejtim. Përvec Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin Institucional, përdoret me efikasitet të plotë faqja e uebit të UART bashkë me sistemin PITAGORA, në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqiptar.<br><br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e sektorit mësimor UART"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe | Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët. Ata sigurojnë informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin. Gjithashtu, ndihmojnë studentët që kanë përfunduar studimet në nivelin e parë për të gjetur mundësi për vazhdim të studimeve ose për punësim. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin e praktikave profesionale, duke ofruar trajnime dhe shërbime të tjera të përmirësuara për zhvillimin e studentëve.<br><br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e sektorit mësimor UART"*<br>*Evidenca 1.15 "Rregullore e studimit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART* |

| | |
|---|---|
| orientimin në tregun e punës. | |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Stduentët ALUMNI janë ndjekur në vazhdimësi nga Departamenti A&T për progresin e tyre në profesion dhe karrierë edhe pas diplomimit. Nga të dhënat e dokumentuara, por edhe nga vizita e GVJ me grup studentësh në institucion e kishin zgjedhur këtë program studimi pasi i ishin përkushtuar dëshirës për të ndjekur talentin e tyre edhe kundër vullnetit të prindërve të tyre.<br><br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e sektorit mësimor UART"* |
| **Konkluzione** | *Të gjitha institucionet ofrojnë shërbime mbështetëse dhe informative për studentët në aspektet mësimore në UART. Këto shërbime përfshijnë orientimin e aplikantëve, informacionin mbi programet dhe kurrikulat e studimeve, këshillimin për diplomimin dhe mundësitë e studimeve të larta, si dhe asistencën për punësim në sektorin publik dhe privat. Bashkëpunimi i ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore, si dhe përdorimi i rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të universitetit, shërbejnë për të siguruar një përkrahje të efektshme për zhvillimin e studentëve në aspektin mësimor. Zyra e Alumni, ndjek studentët pas diplomimit, ofron informacion dhe këshilla për çështjet mësimore, programet e studimeve dhe diplomimin, ndihmon studentët për vazhdimin e studimeve apo punësimin, dhe mbledh të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të diplomuarve të programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e permbushjes së standartit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | UART ofron udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. FAS/Departamenti i A&T operon mbi një strukturë akademike, e cila përshtatet në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e shoqërisë dhe evolucionin e formave të reja të shprehjes artistike. Përvoja praktike është një element thelbësor i programit, duke e vendosur studentin përballë sfidave artitike, por edhe përballë vetvetes. Eksperimentimi skenik është shumë i rëndësishëm, pasi me anë të tij studentët fitojnë një kuptim të thellë mbi gjithë procesin krijues dhe rikrijues të rolit të aktorit të skenës, nga konceptimi fillestar i rolit deri te realizimi i plotë i veprës në skenë. Përmes një ekuilibri mes teorisë dhe praktikës, studentët pregatiten jo vetëm për të qenë pjesë e skenës teatrore kombëtare dhe ndërkombëtare, por edhe për të sjellë qasje të reja krijuese në fushën e interpretimit të veprave skenike.<br><br>*Evidenca 2.1 "Plani mësimor për tre vitet e fundit në VSA"*<br>*Evidenca 2.2 "Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Aktrim"* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | UART/FAS/Departamenti A&T zbatojnë Mekanizma të vazhdueshëm vlerësimi, duke përmirësuar metodologjinë pedagogjike në përputhje me kërkesat e zhvillimeve më të fundit në skenën teatrore. Një ndër këto instrumenta është realizimi I sondazheve periodike, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e pedagogëve, lëndës dhe ndikimit të tyre në zhvillimin professional. Në këtë mënyrë arrihet të vlerësohen pikat e dobëta dhe pikat e forta dhe fushat ku nevojiten përmirësime. Po kështu edhe pjesëmarrja në mobilitete, veprimtari artistike apo projekte praktike, shërbejnë për studentët si laboratorë krijues ku mund të eksperimentojnë me vizionin e tyre artistik.<br><br>*(Evidenca 1.5 "Statuti I UART Urdhër Ministri Nr. 319 për miratimin e Statutit të UART")*<br>*(Evidenca 2.10 "Dosja e reporterit të shfaqjeve të pedagogëve, studentëve aktualë dhe ish Alumni")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS")*<br>*(Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësori I stafit akademik")*<br>*(Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite"* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodic të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UART sipas Statutit, përfshin studentët në vlerësimin periodik të mësimdhënies dhe dijes. Studentët monitorojnë përgatitjen e tyre dhe ndikojnë në cilësinë e shërbimeve. Njësia Kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) zhvillon pyetësorë për dobësitë në mësimdhënie dhe performancën e stafit akademik, me rezultatet të diskutuara në mbledhjet e Departamentit. Studentët në programin Aktrim angazhohen që në fillimet e studimeve me zhvillimin e koncepteve skenike, fjalës artistike, teknikave të të folurit, interpretimit të monologut etj., duke i lejuar ata të ndërtojnë një identitet skenik në prani gjithmonë të pedagogut të tyre. Në këtë mënyrë marrëdhëniet student-pedagog në këtë Departament janë të vecanta, pasi edhe nga vizit në institucion na u konfirmua nga studentët që kanë raporte shumë profesionale dhe shumë njerëzore me njëri-tjetrin.<br>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në nivelet institucionale dhe bazë.<br><br>*Evidenca 1.15 "Rregullore e studimit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART")*<br>*(Evidenca 6.2 "Kërkesë nga studenti për përmirësim note")*<br>*(Evidenca 1.5 " Statuti i UART Urdhër ministri nr. 319 për miratimin e Statutit të UART")*<br>*(Evidenca 6.3 "VSA nr. 26 dt. 24.05.2023 Rregullore për zgjedhjet e Këshillit Studentor)* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Departamenti A&T u referohet kritereve dhe objektivave të përcaktuara periodikisht nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së institucionit (NJSBC). Monitorimi dhe sigurimi i cilësisë në UART zhvillohet përmes aplikimit të vazhdueshëm të mjeteve analizuese si anketat, sondazhet dhe sesionet e informimit, të cilat mbledhin të dhëna të rëndësishme për përmirësim institucional. Element i monitorimit të cilësisëështë dhe raporti vjetor i analizës së departamenteve.<br><br>*(Evidenca 6.4 "Foto nga takimet informuese me sektorin mësimor")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS"*<br>*(Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite")* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të | UART inkurajon praktikat e mira në mësimdhënie duke përdorur mekanizmat e vlerësimit dhe rezultateve të marra. Programet mësimore sigurohen që të jenë të përditësuara dhe të përshtatura me nevojat e ndryshueshme të tregut të punës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | *Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite"* | | | |
| **Konkluzione** | *UART shfaq një qasje progresive dhe angazhim të vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes inovacionit dhe përdorimit të teknologjisë. Me udhëzues, manuale dhe trajnime institucionale, institucioni promovon praktika të mira në mësimdhënie. UART tregon një angazhim të vazhdueshëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, përfshirë përdorimin e mekanizmave të vlerësimit dhe analizave të rezultateve. Gjithashtu, UART ndjek një qasje të strukturuar dhe transparente për cilësinë nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka synim për një përqasje të vëmendshme ndaj sugjerimeve dhe propozimeve për ngritjen e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | UART, zbaton një system të brendshëm të strukturuar për sigurimin e cilësisë, me qëllim garantimin e rezultateve të larta akademike, artistike dhe shkencore. NJSBC bashkëpunon ngushtë me departamentet dhe fakultetet për të siguruar një menaxhim të efektshëm të cilësisë. Procedura e përzgjedhjes në këto struktura bëhet çdo 2 vite për të qenë pjesë e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPSBC). Për sigurimin e cilësisë Brenda institucionit, UART e dëshmon perms një strukture të mire organizuar dhe funksionale, e cila siguron politika, sisteme dhe procedura të qarta.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji | NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standardit të Cilësisë (KPSSC) koordinojnë punën në funksion të sigurimit të cilësisë në institucion.<br>Ato janë ngritur dhe funksionojnë mbi bazën e Statutit të UART dhe Rregulloreve përkatëse. |

| | |
|---|---|
| institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | *(Evidenca 1.5"Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 1.16 "VAS 35, dt. 07.12.2021 për miratimin e rregullores së veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Artit Skenik")*<br>*(Evidenca 6.5 "Rregulloja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")*<br>*(Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite")* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | Strategjia e zhvillimit të UART, Statuti dhe rregulloret bazuar në to trajtojnë në mënyrë të veçantë sigurimin e cilësisë së Institucionit. Ato kanë përcaktuar si strukturat ashtu edhe instrumentët e duhur.<br>Për të ruajtur cilesinë, universiteti realizon analizat dhe vlerësimet periodike të efektivitetit të programeve të studimit, me qëllimin për të ofruar një zhvillim të vazhdueshëm dhe të përmirësim në fushën akademike.<br>Puna e bërë për hartimin e RVB dhe DVV, ku janë përfshirë pedagogë, punonjës ndihmës akademik dhe studentë, është tregues i veprimtarisë së vazhdueshme për të siguruar cilësinë.<br>*Evidenca 1.5"Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 1.15 "Rregullore mësimore e ciklit të parë të studimeve Bachelor në UART")*<br>*(Evidenca 6.5 "Rregulloja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")*<br>*(Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS")* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | GVJ u informua se studentët përmes pyetësorëve kanë mundësinë të shprehen për mbarëvajtjen e programit të studimit, burimet e të nxënit, cilësinë e mësimdhënies, kontrollin e njohurive, metodologjinë e pedagogut të lëndës dhe ndjekjen e studentëve me detyrat e kursit dhe gjithë detyrimet e lëndëve. Pyetësori zhvillohet në kushtet e anonimatit të plotës dhe pa praninë e stafit akademik. Edhe nga vizita e GVJ, studentët u shprehën se vlerësimet e tyre ishin krejtësisht mbi baza meritokracie dhe pune konkrete përmes shfaqjeve artistike që realizonin.<br>*Evidencat 1.5"Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit"*<br>*Evidenca 5.18 "Raportimi Vjetor Alumni* |

| **Konkluzione** | *UART, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 ka vendosur politika dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NJSBC dhe KPSSC duke përfshirë studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm, ndjekin një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Bashkëpunimi me institucione të tjera kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e bashkëpunimit.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që I shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë process realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | UART implementon mekanizma dhe procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit të ciklit të parë. Në nivel institucional, UART zhvillon çdo vit Raportin Vjetor, bazuar në Raportet Vjetore të Departamenteve dhe Fakulteteve. Njësitë bazë dorëzojnë raportet vjetore të veprimtarisë, aktiviteteve të brendshme dhe gjithashtu tërësinë e angazhimeve të personelit akademik kryesisht në aktivitete artistike, botime, pjesëmarrje konferencash, marrëveshje bashkëpunimi, projekte kërkimore shkencore dhe mobilitete.<br><br>*Evidenca 1.5"Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS")*<br>*(Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit të Përformancës Vjetore për tre vite")* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimitduhettëpërfshijnër ezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikavedhearritjevemëtë mira, dhemasat e marrapëradresimin e | Referuar RVB por edhe dokumentecionit të ofruar raportet e vlerësimit ndiqen nga grupi i NJSBC me anëtarë të fakultetit nga çdo njësi bazë duke u përpiluar nga GVB I cili kontrollon me detaje procesin e organizimit të dokumentacionit Brenda çdo njësie bazë dhe gjithë përmbajtjes së raportit të vlerësimit sipas formatit të kërkuar. Angazhimi në prodhime artistike dhe forma të ndryshme të artit skenik ofron një bazë të forte për zhvillimin e aftësive profesionale dhe promovimin e artistëve të rinj. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| mangësivedhepërmirësimin nëvijimtëcilësisë, sidhemotivimin e arritjevemëtëmiranëmësimdhekërkimngapersoneliakademikdhestudentët. | *(Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit të Përfamncës Vjetore për tre vite")* |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim I cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi I shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | UART, përdor një vlerësim I cili përfshin monitorim të procesit të mësimdhënies, vlerësim I çdo lënde nga studentët, analizën e rezultateve të studentëve në provime, vlerësimin e arritjeve të studentëve në detyrat e kryera gjatë zhvillimit të programit, vëzhgimin e performances gjatë praktikave, rezultatet nga punimet e diplomës. Ky process rrit standartet e programeve mësimore, por gjithashtu përgatit studentët me aftësi të specializuara në tregun e punës.<br><br>*Evidenca 1.25"Raportet e Vlerësimit të Përfamncës Vjetore për tre vite")*<br>*(Evidenca 5.13 "Agjenda Open Day")*<br>*(Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve, studentëve aktualë dhe ish Alumni")* |
| **Kriteri 4.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për | Njësia bazë përdor pyetësorë, teste dhe sondazhe për vlerësim, duke synuar matjen e performancës së stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Këto metoda sigurojnë një analizë të detajuar të performancës së programit në përputhje me nevojat e studentëve dhe standardet e përcaktuara. Kontakti i vazhdueshëm me studentët ALUMNI për përfshirjen e tyre në tregun e punës, studentët kanë mundësi të fitojnë përvojë praktike në mjedise profesionale, duke u përfshirë drejpërdrejt në sektorin artistik dhe kulturor.<br><br>*Evidenca 4.8 "Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta")*<br>*(Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor")*<br>*( Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësori i stafit akademik")*<br>*(Evidenca 5.18 "Raportimi Vjetor Alumni")*<br>*(Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART")* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | | | | |
| **Konkluzione** | *UART ka procese formale për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, duke i dokumentuar ato në Raportin Vjetor. Raportet janë të detajuara duke përfshirë strategji efikase për përmbushjen sa më mirë të standarteve të cilësisë së mësimdhënies. Ruajtja e marrëdhënieve me studentët ALUMNI dhe mundësia e angazhimit të tyre në institucion me veprimtari të ndryshme, siguron një qëndrueshmëri të programit të studimit në tregun e punës.*<br>*Nga vizita e GVJ, konfirmuam angazhimin e studentëve në projekte, veprimtari pranë institucioneve të rëndësishme me të cilat UART ka marrëveshje ku të praktikojnë në mënyrë profesionale njohuritë e fituara.*<br>*Vetë këto studentë bëhen shpesh promotorë të nismave të reja në të cilat angazhohen dhe shërbejnë si ura llidhëse edhe për institucionin dhe vazhdimësinë e projekteve artistike.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.**<br>Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Departamenti A&T zbaton politika dhe procedura të brendshme të cilësisë për programet e studimit. Ajo angazhohet në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit, duke përfshirë aktorë të jashtëm të interesuar. Gjithashtu, për përmirësimin e përmbajtjes së programit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, zyra e Alumni janë pjesëmarrës dhe promovojnë programet në evente të ndryshme, duke marrë parasysh propozimet dhe eksperiencat e maturantëve dhe studentëve.<br><br>*(Evidenca 1.5 "Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")* |
| **Kriteri 2.**Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, | Institucioni promovon rolin e individëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç në vlerësimin dhe |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| individët, studentët dhe pale të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, të përfaqësuar me një grup të tërë pune. Këto struktura bashkë me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm janë përgjegjëse për të ndjekur procesin e sigurimit të cilësisë institucionale.<br><br>*Evidenca 1.5 "Statuti I UART Urdhër ministr nr. 319 Për miratimin e Statutit")*<br>*(Evidenca 6.5"Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")*<br>*(Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART")*<br>*(Evidenca 5.16 "Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS")*<br>*(Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësori i stafit akademik")* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Institucioni thekson rëndësinë e rolit të individëve dhe studentëve në sigurimin e cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.<br><br>*Evidenca 1.9.1, "Urdhri i Dekanit Prof. Miltiadh Kutali 03.02.2025 Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm në kuadër të akreditimit bachelor FAS")* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Në Njësinë Bazë të Departamentit A&T, në UART, nuk janë evidentuar dukuri negative në lidhje me cilësinë e procesit mësimor dhe fushën akademike. Përpjekjet janë bërë për të trajtuar edhe dobësitë në mënyrë të kujdesshme dhe jo të drejtpërdrejtë. Aktet normative të brendshme janë taksative dhe rigoroze, duke përfshirë Kodine Etikës dhe rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, duke u mbështetur në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. (Ligji 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri)<br>Institucioni siguron një mjedis të barabartë për të gjithë anëtarët e komunitetit universitar, pa raste të evidentuara të diskriminimit.<br><br>*Evidenca 1.9.1 "Urdhri i Dekanit Prof. Miltiadh Kutali 03.02.2025 Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e brendshëm në kuadër të akreditimit bachelor FAS* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të | Programi Bachelor në Aktrim ka kultivuar një bashkëpunim të vazhdueshëm akademik dhe profesional me institucione të njohura artistike, duke realizuar masterclasa dhe workshope. Këto nisma |

| | |
|---|---|
| cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | kanë ndihmuar në përshtajen e programit me standartet më të avancuara ndërkombëtare.<br>Mobilitetesi Erasmus +, kanë mundësuar zgjerimin e dimensionit ndërkombëtar në kuadrin e zhvilimit të mëtejshëm professional të stafit dhe studentëve. Për të qenë sa më konkurues në treg, FAS fton ekspertë të jashtëm të kontribuojnë në cilësinë akademike të programeve të studimit dhe nivelin artistic të tyre.<br><br>*Evidenca 3.3 "Aktivitete të ëorkshopeve, masterklasave 2022-2024")* |
| **Konkluzione** | *Njësia Bazë ka politika të brendshme për cilësi, përfshirë aktorë të jashtëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Institucioni vlerëson rolin e individëve dhe studentëve për cilësi, ndërsa Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe komisionet e departamentit luajnë rol kyç.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | UART përcakton një parim kryesor në drejtim të transparencës dhe publikon informacionin lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet faqes zyrtare dhe programit të transparencës në linkun http://www.artacademy.al/index.php menuja "Transparenca".<br>Në këtë drejtim, përfshihen mekanizmat kontrollues, planet strategjike, raportet vjetore të veprimtarive akademike dhe monitorimit të cilësisë së programeve të studimit. Njësia Bazë ndjek këtë praktikë duke përdorur mjetet e veta të komunikimit në faqen e internetit.<br><br>*(Evidenca 3.3"Aktivitete të ëorkshopeve, masterklasave 2022-2024")*<br>*(Evidenca 2.10 "Dosja e repertorit të shfaqjeve të pedagogëve, studentëve aktualë dhe ish Alumni")* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar larine dhe etikën akademike, si dhe | UART, në përputhje me parimet e lirisë dhe etikës akademike, si dhe në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale, respekton këto vlera në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit. Raportet publikohen në respekt të anonimitetit dhe të përgjithësuara në fokus të rezultateve të analizave të pyetësorëve. |

| | |
|---|---|
| legjislacionin për të dhënat personale. | *(Evidenca 1.5 "Statuti i UART Urdhër Ministri Nr. 319 për miratimin e Statutit të UART")*<br>*(Evidenca 6.5 "Rregullorja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë")*<br>*Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART")* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Raportet e vlerësimit i trajtojnë pikat e forta dhe të dobëta, duke hartuar detyra dhe afate për përmirësim. Të gjitha raportet vjetore, anketat dhe vlerësimet shoqërohen me analiza të hollësishme, duke korigjuar problematikat e identifikuara dhe garantuar një rrritje të qëndrueshme të cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit. Ky proces synon të rrisë cilësinë akademike në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me standartet më të larta të përcaktuara.<br><br>*Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit vjetor për tre vitet* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | UART përdori me efektivitet këto procese më një qëllim thelbësor: përmirësimin vazhdueshëm të cilësisë me përfshirje të stafit akademik, ndihmës-akademik dhe studentë. Përmes procesit të vlerësimit të jashtëm, vlerësimit të brendshëm dhe procesit të akreditimit, evidentohen aspektet që mund të përmirësohen. Zbatohen masa konkrete për përditësimin e programeve mësimore, duke i përshtatur me standartet akademike dhe me dinamikat e tregut të punës.<br><br>*Evidenca 1.9.2 "Urdhri 345 prot. dt.19.02.2025 Për ngritjen e grupeve të punës për rishikimin e kurrikulave të programit të studimit Bachelor FAS")*<br>*(Evidenca 1.25 "Raportet e Vlerësimit të Performancës Vjetore për tre vite")* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afat gjatë të cilësisë së programit të studimit. | Departameenti A&T zbaton veprimtari periodike, përfshirë sondazhe, anketime, dhe plotësimin e formularëve të kontrollit. Këto aktivitete janë pjesë e një strategjie afatgjatë për sigurimin e cilësisë në programet e studimit dhe zhvillimin e tyre. Përmes fushatave informuese, personeli akademik dhe studentët janë të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e përmirësimit të cilësisë dhe janë inkurajuar të marrin pjesë aktivisht.<br><br>*Evidenca 6.4 "Foto nga takime informuese me Sektorin Mësimor")*<br>*(Evidenca 3.7 "Të dhëna nga pyetësorët e studentëve në FAS")*<br>*(Evidenca 6.1 "Të dhëna nga pyetësori i stafit akademik")* |
| **Konkluzione** | *UART me transparence të plotë publikon sondazhet e studentëve në faqen zyrtare të saj.*<br>*Ndjekin strategji të mirëmenduara me focus përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies apo problematikave të tjera të gjetura nga sondazhet. Ka një bashkëpunim institucional shumë të mirë, duke* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *bashkërenduar punën e departamentit me strukturat e tjera përgjegjëse në funksion të përmbushjes së standarteve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Aktrim" ofrua nga Universiteti i Arteve.</u>**

**Pika të forta dhe afirmime**

1. Programi i Studimit Bachelor në Aktrim është në përputhje me misionin, strategjinë e institucionit, fushën akademike të departamentit dhe nevojat e tregut. Programi ka një përvojë mbi 60 vjeçare dhe kombinon traditën më bashkëkohoren në strukturë, përmbajtje dhe metodat e mësimit.
2. Kurrikula e programit është e konsoliduar dhe e përshtatur më së miri me tregun e punes duke u ofruar studentëve një mundësi më shumë per t'u përballur më te pergatitur me realitetin e së ardhmes. Kërkesa e lartë për këtë program, përgatitja e artisëvë të kërkuar në treg, dhe formimi i qindra emrave të spikatur të artit vendas të fushës së aktrimit skenik e më gjërë janë dëshmitarë të cilësisë së kësaj kurrikule.
3. Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përbëhet nga personel i kualifikuar dhe me përvojë të spikatur të fushës së aktrimit në vend, duke e kthyer Departamentin e Aktrim dhe Teori si institucion në destinacionin më të kërkuar në rang kombëtar në fushën e aktrimit. Departamenti i A&T/FAS dallohet jo vetem për vlerat akademike dhe kapacitetet artistike që zotëron, por edhe per trashëgiminë dhe vlerat arsimore e edukative që mbart e përcjell.
4. Bashkëpunimi dhe komunikimi me institucione kulturore, arsimore, artistike, apo sektorë të caktuar te tregut te punës për zhvillimin e praktikave dhe veprimtarive artistike. Lidhje efikase me Alumni.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e një programi të ngjashëm në arsimin e lartë në Shqipëri për të patur një konkurrent, që do ndihmonte më shumë për t´u përsosur. Ky program studimi ka vetëm veten konkurrent të vetëm në institucionet e arsimit te lartë publik në vend. [(Standard II.1/ Kriteri 6)]

2. Mungesa e literaturës së përditësuar për programin Bachelor në Aktrim. [(Standard II.4/Kriteri 5)]

**Rekomandime:**

1. Të punohet për përfshirjen e profesionit të Aktorit në listën e profesioneve të rregulluara në përpiuthje me ligjet në fuqi.
2. Të punohet për të rritur numurin e studentëvë ve regjistruar në këtë program dhe për rritjen e interesit të të rinjve për programin.
3. Të pasurohet dhe përditësohet fondin fizik dhe elektronik të literaturës në gjuhën shqipe dhe të huaj në fushën e aktrimit me botime të viteve të fundit .
4. Të mundësohet një rikonstruksion total apo i pjesshëm i godinës së FAS/UART, për shtimin dhe përmirësimin e strukturës pedagogjike.
5. Të zgjerohet bashkëpunimi me institucionet e tjera kulturore për të krijuar ura të tjera lidhje si në nivel stafi akademik, ashtu dhe për një angazhim më të madh të studentëve në projektet dhe strukturat e tyre.
6. Të mundësohet lidhja me Alumni që nuk jetojnë më në Shqipëri, një mundësi më e madhe për zhvillimin cilësor të programit të studimit.
7. Në kuadër të marrëveshjes Erasmus+ të nxiten e të përfshihen studentët e këtij programi në këto projekte dhe mobilitete .

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Acting" University of Arts.**

**Strengths and Affirmations**

1. The Study Program of the first cycle Bachelor in Acting is in line with the mission, strategy of the institution, the academic field of the department and labour market needs. The program has over 60 years of experience and combines tradition with the most contemporary trends in structure, content and teaching methods.
2. The program's curriculum is consolidated and best adapted to the labor market, offering students an additional opportunity to face the reality of the future better prepared. The high demand for this program, the preparation of artists in demand in the market, and the formation of hundreds of prominent stage actors are testament to the quality of this curriculum.
3. The full-time and part-time academic staff consists of qualified personnel with outstanding experience in the field of acting in the country, making the Department of Acting and Theory as an the most sought-after destination institution at home in the field of acting. The Department of

A&T/FAS is distinguished not only for the academic values and artistic capacities it possesses, but also for the heritage and educational values it carries and transmits.

4. Cooperation and communication with cultural, educational, artistic institutions, or certain sectors of the labor market for the development of artistic practices and activities. Efficient connections with Alumni.

**Weaknesses:**

1. Lack of a similar program in higher education in Albania to have a competitor, which would help more to improve. The only competitor for this program in public higher education institutions in the country is itself. [(Standard II.1/ Criterion 6)]
2. Lack of updated literature for the Bachelor in Acting program. [(Standard II.4/ Criterion 5)]

**Recommendations:**

1. Work to include the profession of Actor in the list of regulated professions in accordance with the laws in force.
2. Work to increase the interest of young people in the program and the number of those enrolled in it.
3. Enrich and update the physical and electronic fund of literature in Albanian and foreign languages in the field of acting with publications from recent years.
4. Enable a total or partial reconstruction of the FAS/UART building, to increase and improve the pedagogical structure.
5. Expand cooperation with other cultural institutions to create other bridges of connection both at the academic staff level, and for a greater commitment of students in their projects and structures.
6. To enable the connection with Alumni who no longer live in Albania, a greater opportunity for the qualitative development of the study program.
7. Within the framework of the Erasmus+ agreement, to encourage and include students of this program in these projects and mobilities

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |